

LIGJI Nr. 05/L-082

PËR GAZIN NATYROR

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR GAZIN NATYROR

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij ligji është të krijojë kornizën ligjore për transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, përdorimin dhe depozitimin e gazit natyror.
2. Ky ligj përcakton organizimin dhe funksionimin e sektorit të gazit natyror, qasjen ndaj tregut, kriteret dhe procedurat për dhënien e autorizimeve për transmetimin, shpërndarje, furnizim, përdorim, depozitim të gazit natyror dhe operimin e sistemeve.
3. Ky Ligj është në përputhshmëri me Direktiven Nr. 2009/73/EC për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe Rregulloren Nr. 715/2009/EC për kushtet e qasjes në rrjetet e bartjes të gazit natyror.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Ky ligj zbatohet me qëllim të përcaktimit të rregullave në lidhje me organizimin dhe funksionimin e sektorit të gazit natyror, caktimin e rregullave jodiskriminuese për objektet e depozitimit, duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të tregjeve kombëtare dhe rajonale dhe lehtësimin e krijimit të një tregu të shitjes me shumicë, funksionale dhe transparente me një nivel të lartë të sigurisë së furnizimit me gaz dhe sigurimin e mekanizmave për të harmonizuar rregullat për qasje në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të gazit.
2. Rregullat e përcaktuara në këtë ligj do të zbatohen në mënyrë jodiskriminuese edhe për biogazin dhe gazin nga biomasa ose llojet tjera të gazit, deri në masën në të cilën gazrat mund të injektohen teknikisht dhe në mënyrë të sigurt, si dhe të transportohen nëpërmjet sistemit të gazit natyror.

Neni 3 Përkufizimet

1. Termat e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Transmetim** - transportimi i gazit natyror me anë të rrjetit të tubacioneve, që kryesisht përbëhet nga tubacione me presion të lartë, përveç rrjetit të tubacioneve të rrjedhës së sipërme, si dhe ndryshe nga pjesa e gypave me presion të lartë që kryesisht përdorën në kontekstin e shpërndarjes lokale të gazit natyror, me qëllim të dërgimit të tij tek konsumatorët, por pa e përfshirë furnizimin;

1.2. **Linjë interkoneksioni** - është një linjë transmetimi, e cila lidh sistemet e transmetimit të gazit ndërmjet dy shteteve - Palëve Kontraktuese;

1.3. **Furnizimi** - shitja, duke përfshirë edhe rishitjen, e gazit natyror deri të konsumatorët e fundit;

1.4. **Gazi natyror** - përzierja e komponimeve të hidrokarbureve, në gjendje të gaztë ose në përzierje me naftën e papërpunuar në rezervuarët natyrorë nëntokësorë në kushte rezervuari. Hidrokarburet parësore, që zakonisht gjenden në përzierje, janë: metani, etani, propani, butani dhe pentani;

1.5. **Konsumator** – konsumatori me shumicë apo konsumator fundor i gazit natyror, ose ndërmarrje e gazit natyror që blejnë gazin natyror;

1.6. **Konsumator familjar**– konsumatorët që blejnë gazin natyror për konsumim për ekonomitë e tyre familjare;

1.7. **Konsumator jofamiljar**– person fizik a juridik që blen energji elektrike të cilën nuk e shfrytëzon për nevoja të veta familjare, e ku përfshihen edhe prodhuesit dhe blerësit me shumicë;

1.8. **Konsumator fundor** - konsumatorët që blejnë gazin natyror për shfrytëzimin e tij për nevoja vetjake;

1.9. **Konsumator me shumicë** - personi fizik ose juridik, përveç operatorëve të sistemit të transmetimit të gazit natyror dhe operatorëve të sistemit të shpërndarjes, të cilët e blejnë gazin natyror me qëllim të rishitjes brenda ose jashtë sistemit në të cilin janë të lidhur;

1.10. **Konsumator në nevojë** - konsumatori amvisëror që kualifikohet për mbrojtje ose ndihmë sipas rregullave të përcaktuara nga ana e ministrisë përgjegjëse për mirëqenie sociale në bazë të nenit 10 të këtij ligji;

1.11. **Lidhja në sistemin e gazit** - lidhje fizike në rrjetet e transmetimit, depozitimit, shpërndarjes, në pajtim me kushtet teknike të përcaktuara;

1.12. **Kontrolli** - të drejtat, obligimet, kontratat ose mjetet e tjera, të ndara ose të kombinuara, që rrjedhin nga ndonjë ligj apo fakt, e që bartin mundësinë e ushtrimit të ndikimit vendimtar mbi pasuritë e një ndërmarrjeje, e në veçanti përmes:

1.12.1. pronësisë ose të drejtës së shfrytëzimit të të gjitha apo një pjese të aseteve të një ndërmarrjeje; ose

1.12.2. të drejtave apo kontratave të cilat bartin ndikimin vendimtar në përbërje, votim apo vendime të organeve të një ndërmarrjeje;

1.13. **Depozitim në linjë tubacioni (“Linepack”)** – depozitimi i gazit nën presion në sistemet e transmetimit dhe të shpërndarjes së tij, por duke i përjashtuar stabilimentet e rezervuara për operatorët e sistemit të transmetimit në kryerjen e funksioneve të tyre;

1.14. **Linjë direkte** - një tubacion i gazit natyror, mbështetës i sistemit të ndërlidhur, që lidh një burim të gazit me një konsumator;

1.15. **Ministria** - nënkupton Ministrinë përgjegjëse për sektorin e energjisë;

1.16. **Ndërmarrja e gazit natyror** - personi fizik apo juridik i cili kryen së paku një nga funksionet në vijim: prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin, blerjen, ose depozitimin e gazit natyror, e që është përgjegjës për detyrat komerciale, teknike dhe/ose të mirëmbajtjes në lidhje me këto funksione, por nuk përfshin konsumatorët fundorë;

1.17. **Ndërmarrje furnizuese** - person fizik ose juridik, i cili kryen funksionin e furnizimit;

1.18. **Ndërmarrja e integruar e gazit natyror** - ndërmarrja e integruar vertikalisht, apo horizontalisht;

1.19. **Ndërmarrja e integruar vertikalisht** - ndërmarrja, apo grupi i ndërmarrjeve të gazit natyror ku i njëjti person apo persona kanë të drejtë, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, për të ushtruar kontroll dhe ku ndërmarrja apo grupi i ndërmarrjeve kryen së paku një nga funksionet e transmetimit shpërndarjes, depozitimit dhe së paku një nga funksionet e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror;

1.20. **Ndërmarrja e integruar horizontalisht** - ndërmarrje që kryen së paku një nga funksionet e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit, apo depozitimit të gazit natyror, si dhe një aktivitet jo të lidhur me gazin;

1.21. **Operatori i Sistemit të Transmetimit** – person fizik apo juridik që kryen funksionin e transmetimit dhe që është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të transmetimit në një zonë të caktuar, përfshirë edhe interkonekcionet e mundshme me sistemet tjera, dhe për garantimin e aftësinë afatgjate të sistemit për të plotësuar kërkesë për transmetimin e gazit natyror;

1.22. **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes** - person fizik apo juridik që kryen funksionet e shpërndarjes dhe është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, në një zonë të caktuar përfshirë edhe interkonekcionet e mundshme me sisteme tjera dhe për garantimin e aftësinë afatgjate të sistemit për të plotësuar kërkesën për shpërndarjen e gazit natyror;

1.23. **Operatori i Sistemit të Depozitimit** - person fizik apo juridik i cili kryen funksionin e depozitimit dhe është përgjegjës për operimin e stabilimentit të depozitimit;

1.24. **Palë e Komunitetit të Energjisë** - çdo palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

1.25. **Planifikimi afatgjatë** –nënkupton planifikim i nevojave për furnizim të kapaciteteve transmetuese të ndërmarrjes së gazit natyror në baza afatgjate me qëllim të plotësimit të nevojave të sistemit me gaz natyror, diversifikim të burimeve dhe sigurim të furnizimit për konsumatorë;

1.26. **Rrjeti i tubacioneve të rrjedhës së epërme** - secili tubacion, apo rrjet tubacionesh të operuara dhe/ose ndërtuara si pjesë e një projekti të prodhimit të naftës apo gazit, apo i përdorur për ta transportuar gazin natyror nga një apo më shumë projekte të tilla te stabilimenti, apo centrali përpunues, ose te terminali i vendosjes përfundimtare bregdetare;

1.27. **Stabiliment depozitimi** - stabilimenti që përdoret për depozitimin e gazit natyror dhe është pronë dhe/ose operohet nga një ndërmarrje e gazit natyror, i përdorur për depozitim, duke përjashtuar pjesën e përdorur për operacionet prodhuese, si dhe duke përjashtuar stabilimentet e rezervuara ekskluzivisht për operatorët e sistemit të transmetimit në kryerjen e funksioneve të tyre;

1.28. **Sistem** - është çdo rrjet transmetimi, shpërndarjeje, hapësire depozitimi, zotëruar ose operuar nga një ndërmarrje e gazit natyror, përfshirë *linepack*-un, instalimet e tij, që sigurojnë shërbimet ndihmëse, si dhe ato që janë të nevojshme për hyrjen në transmetim dhe shpërndarje;

1.29. **Siguri** - siguria e furnizimit të gazit natyror, si dhe siguria teknike;

1.30. **Sistem i interkoneksionit** – disa sisteme të transmetimit dhe shpërndarjes të lidhura mes tyre;

1.31. **Shpërndarja** - transporti i gazit natyror me anë të rrjeteve lokale, apo rajonale të tubacioneve me qëllim të dërgimit të konsumatorët, por duke mos përfshirë furnizimin;

1.32. **Shërbimet ndihmëse** - të gjitha shërbimet e nevojshme për qasje dhe operim të rrjeteve të transmetimit, të shpërndarjes dhe/ose stabilimenteve të depozitimit, duke përfshirë balancimin e ngarkesës, përzierjen dhe injektimin e gazrave inerte, por duke mos përfshirë stabilimentet e rezervuara ekskluzivisht për operatorët e sistemit të transmetimit që kryejnë funksionet e tyre;

1.33. **Detyrimet e shërbimit publik** - detyrime që vendosen, me ligj apo me një vendim të miratuar nga Qeveria apo Rregullatori, varësisht nga fushat e përgjegjësisë së tyre, për një ndërmarrje të gazit natyror, që të ndërlidhen me sigurinë, duke përfshirë sigurinë e furnizimit, rregullsinë, cilësinë dhe çmimin e furnizimit, eficientë e energjisë, energjinë nga burimet e ripërtërishme, si dhe mbrojtjen e mjedisit dhe klimës, që nuk janë diskriminuese dhe nuk shtrembërojnë konkurrencën përveç kur është e domosdoshme për të siguruar shërbimin publik në fjalë;

1.34. **Derivativ i gazit natyror** - një instrument financiar që mund të përdoret nga pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror si mjet sigurie ndaj luhatjeve të mundshme të çmimit të gazit në treg;

1.35. **Infrastruktura e re** – është infrastruktura që nuk ka përfunduar deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji;

1.36. **Shfrytëzuesit e sistemit** - persona fizikë apo juridikë që furnizojnë apo që furnizohen nga sistemi;

1.37. **Kontratë e furnizimit me gaz** – kontrata për furnizimin me gaz natyror, por që nuk përfshin derivativat e gazit natyror;

1.38. **Hapësira** – vëllimi i deponisë së gazit për të cilën përdoruesi gëzon të drejtën për depozitimin e gazit;

1.39. **Shkalla e realizimit** - shkalla në të cilën përdoruesi i objektit të depozitimit mund të tërheqë gaz nga objekti i depozitimit;

1.40. **Shkalla e injektimit** - shkalla në të cilën përdoruesi i objektit të magazinimit ka të drejtë të injektojë gaz në objektin e magazinimit;

1.41. **Kapaciteti i depozitimit** – çdo kombinim të hapësirës, shkallës së injektimit dhe shkallës së realizimit;

1.42. **Kapaciteti kombëtar i depozitimit** - çdo kombinim i kapaciteteve të depozitimit brenda vendit;

1.43. **Kapaciteti rajonal i depozitimit** - çdo kombinim i kapaciteteve të depozitimit brenda palëve të kontraktuara;

1.44. **Shtet i tretë** - çdo shtet që nuk është Palë e Komunitetit të Energjisë, apo anëtar i Zonës Ekonomike Evropiane;

1.45. **Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (ECS)** - institucioni që siguron mbështetje administrative për Këshillin Ministror, për Grupin e Nivelit të Lartë të Përhershëm, për Bordin Rregullator dhe për Forumet, në udhëheqjen e procesit të zhvillimit të Komunitetit të Enërgjisë;

2. Termat tjera të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Energjinë dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 4

Politikat e sektorit të gazit natyror

1. Ministria është përgjegjëse për hartimin e politikave në sektorin e gazit natyror, në konsultim me Zyrën e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejshëm: Rregullatori) dhe organet tjera qeveritare. Politikat e hartuara për sektorin e gazit natyror do të jenë pjesë e Strategjisë së Energjisë dhe Programit për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë. Politikat e gazit natyror do të marrin parasysh së paku komponentët në vijim:

1.1. ndërtimi i kornizës së duhur institucionale, duke marrë parasysh autoritetin kompetent për zbatimin e politikës së tillë;

- 1.2. sigurimi i furnizimit të sigurt me gaz natyror;
- 1.3. elaborimi dhe zhvillimi i programeve investuese në sektorin e gazit natyror;
- 1.4. vlerësimi dhe disponueshmëria e politikave efektive për të siguruar transparencë të drejtimit të zhvillimit të tregut të gazit natyror;
- 1.5. rritja e efikasitetit në lidhje me prodhimin, depozitimin, transmetimin, shpërndarjen dhe shfrytëzimin e gazit natyror;
- 1.6. specifikimi i drejtimeve të kërkimeve dhe zhvillimet e mundshme për sektorin e gazit natyror dhe promovimi i teknologjive të avancuara në këtë fushë;
- 1.7. propozimi dhe hartimi i akteve nënligjore në sektorin e gazit natyror.

2. Ministria siguron përmbushjen e këtyre elementeve duke ndërmarrë veprimet si në vijim:

- 2.1. hartimin e programeve dhe planeve për zbatimin e politikës deri në masën që agjencitë tjera nuk kanë autoritetin primar mbi to;
- 2.2. ndërmarrja e studimeve mbi pikat prioritare të politikave;
- 2.3. bashkëpunimi me Rregullatorin dhe subjekteve tjera udhëheqëse të sektorit të gazit natyror;
- 2.4. monitorimin e aplikimit dhe përputhshmërisë së masave të përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit nga agjencitë përkatëse;
- 2.5. sigurimin e harmonizimit me standardet dhe me legjislacionin e Bashkimit Evropian në sektorin e gazit natyror, si dhe krijimin e mekanizmave të nevojshëm për zbatimin e tyre;
- 2.6. propozimin, elaborimin dhe zhvillimin e programeve sociale për konsumatorë në nevojë, në konsultim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenie sociale, asociacionet tjera dhe organizatat sindikale, si dhe zhvillimin e akteve në pajtim me normat e mbrojtjes në punë për sektorin e gazit natyror;
- 2.7. krijimi i kushteve për të mundësuar që të gjitha ndërmarrjet e gazit natyror të lidhen me funksion të transmetimit apo shpërndarjes si një sistem unik i gazit natyror.

3. Sistemi i gazit natyror në Kosovë duhet të jetë në pajtueshmëri me standardet e përbashkëta teknike dhe të sigurisë dhe i integruar në sistemin/tregun rajonal të gazit.

Neni 5

Aktivitetet e furnizimit me gazin natyror

1. Një ndërmarrje e gazit natyror që bartë licencë për furnizim me gaz natyror mund të angazhohet në furnizimin me gaz natyror për cilindo konsumator, në pajtim me këtë ligj.

2. Çdo konsumator në Kosovë, përfshirë konsumatorët fundorë dhe me shumicë, do të kenë të drejtë të zgjedhjes së lirë të furnizuesve dhe ndërrimit të tyre.

3. Pa paragjykuar në mundësitë e Rregullatorit të imponojë obligime të shërbimit publik për qëllime të caktuara dhe për një periudhë të kufizuar kohore, furnizimi me gaz natyror do të sigurohet me çmime të parregulluara të tregut, në bazë të kontratave të negociuara mes furnizuesit dhe konsumatorit.

4. Të gjithë furnizuesit do të blejnë gazin natyror për furnizim të konsumatorëve në tregun bilateral apo të organizuar të gazit natyror.

5. Rregullat mbi kushtet e përgjithshme, të cilat miratohen nga Rregullatori, do të jenë obligative për të gjithë furnizuesit që operojnë në Kosovë, përveç nëse është përcaktuar shprehimisht ndryshe në këtë ligj. Kushtet e përgjithshme do të përcaktojnë kërkesa objektive, transparente dhe jodiskriminuese të cilat duhet të aplikohen në mënyrë të barabartë për të gjitha ndërmarrjet e gazit natyror, varësisht nga veprimtaria e tyre në tregun e gazit natyror. Kushtet e përgjithshme do të bëhen publike në faqen e Rregullatorit në internet dhe në faqet e furnitorëve të ndryshëm.

Neni 6

Rregullat e ndërrimit të furnizuesit

Rregullatori siguronë zbatimin e një procedure efikase e cila i mundëson një konsumatori fundor që të ndërrojë furnizuesin sa më thjeshtë që të jetë e mundur, brenda një periudhe prej më pak se njëzetënjë (21) ditësh pas njoftimit të furnizuesit të tij të mëparshëm mbi qëllimin për të kaluar tek një furnizues tjetër, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 7

Konsumatorët fundor

1. Konsumatori fundor gëzon mbrojtje në pajtim me këtë ligj dhe aktet nenligjore të nxjerra në bazë të këtij ligji, si dhe në bazë të legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Konsumatori fundor paguan për gazin natyror në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe kushtet tjera të kontraktuara. Kushtet dhe procedurat e faturimit, inkasimit dhe pagesës do të përcaktohen me akte nenligjore të miratuara nga Rregullatori.

3. Çdo konsumator fundor ka të drejtë të posedojë të dhënat relevante në lidhje me konsumin e tij të gazit natyror dhe do të jenë në gjendje që pa pagesë, dhe në bazë të marrëveshjes shprehimore, t'iu ofrojnë të gjithë furnizuesve të regjistruar qasje në të dhënat e njehsorëve të tyre. Pala përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave do të jetë e obliguar që t'ia japë të dhënat e tilla ndërmarrjes. Kushtet e përgjithshme do të definojnë formatin e të dhënave dhe procedurën përmes së cilës furnizuesit dhe konsumatorët fundorë do të kenë qasje në të dhënat në fjalë. Për këtë shërbim konsumatorët fundorë nuk do të kenë kosto shtesë.

4. Konsumatorët e mëdhenj jofamiljarë do të kenë të drejtë të kontraktimit të disa furnizuesve në të njëjtën kohë. Rregullatori do të miratojë, në pajtim me këtë ligj, rregullat të cilat do t'ua garantojnë konsumatorëve të mëdhenj jofamiljarë ushtrimin e kësaj të drejte.

5. Në rast të pengesave teknike apo tjera në livrimin e gazit natyror, e të cilat nuk janë shkaktuar nga stabilimentet e konsumatorëve fundorë, konsumatori fundor do të ketë të drejtë të kërkojë shmangien e pengesave të tilla brenda periudhës më të shkurtër të mundshme, nën kushtet

dhe afatet e përcaktuara në rregullat e zbatueshme të rrjetit.

6. Ndalesat në furnizim si rrjedhojë e zbatimit të masave për kufizimin e livrimit, të cilat ndërmerren në rast të lëkundjeve në tregun e gazit natyror nuk do të konsiderohen si pengesa në livrim të gazit natyror, të cilave iu referohet në paragrafin 5. të këtij neni.

7. Konsumatorët fundorë do të shfrytëzojnë gazin natyror nën kushtet, mënyrën dhe qëllimet e përcaktuara me këtë ligj, rregullat e Rrjetit të Transmetimit, rregullat e Rrjetit të Shpërndarjes, aktet tjera të zbatueshme, dhe në pajtim me obligimet kontraktuese përkatëse.

Neni 8

Kushtet e përgjithshme të furnizimit me gaz natyror

1. Të drejtat dhe obligimet e furnizuesit dhe konsumatorit fundor do të rregullohen me kontratën për furnizim me gaz natyror.

2. Lidhja dhe përmbajtja e kontratës për furnizim me gaz natyror do të përcaktohen më tej në rregullat e përgjithshme, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

3. Kushtet e përgjithshme, në kuptim të kontratës për furnizim me gaz natyror, do të përmbajnë në veçanti si në vijim:

3.1. metodën për ndryshimin e kushteve të kontraktuara të furnizimit;

3.2. të drejtën e konsumatorit fundor për të shkëputur kontratën;

3.3. metodën për njoftimin e ngritjes së çmimit para fillimit të aplikimit të ngritjes;

3.4. metodën për njoftimin e çmimeve të vlefshme, afateve dhe kushteve standarde, në veçanti të atyre që ndërlidhen me qasjen dhe shfrytëzimin e shërbimeve; dhe

3.5. ndalesën për çdo konsumator fundor që të mbajë çfarëdo të dhëna të kontratës, kalkulimeve dhe faturave, e në veçanti çmimet, mënyrat për ndryshimin e çmimeve dhe të dhënat e njehsorëve, si të dhëna konfidenciale.

4. Çdo furnizues do të sigurojë që kushtet e kontratës për furnizim me gaz natyror që i ofron furnizuesi të jenë në pajtim me Kushtet e përgjithshme. Kushtet e kontratës do të jenë të shkruara në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme dhe nuk do të përmbajnë barriera jokontraktuese për ushtrimin e të drejtave nga konsumatorët, përfshirë barrën e tepërt administrative apo dokumentacionin e tepërt kontraktues. Çdo furnizues do të sigurojë mbrojtjen e konsumatorëve fundorë nga metodat e padrejta dhe çorientuese të shitjes.

5. Çdo furnizues do të përgatitë dhe publikojë në mënyrë adekuate kushtet standarde për lidhjen e kontratës për furnizim me gaz natyror, që përmbajnë kushtet e përcaktuara paraprakisht. Të gjithë furnizuesit gjithashtu do të publikojnë çmimet e zbatueshme apo tarifën e rregulluar, varësisht nga situata.

6. Bazuar në Kushtet e përgjithshme, të gjithë konsumatorëve fundorë do t'iu sigurohet:

6.1. e drejta për të lidhur kontratë me furnizuesit, në të cilën specifikohen:

6.1.1. identiteti dhe adresa e furnizuesit;

6.1.2. shërbimet e ofruara, niveli i cilësisë së shërbimeve të ofruara, si dhe koha e lidhjes fillestare;

6.1.3. llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes, nëse të njëjtat ofrohen;

6.1.4. mjetet përmes të cilave mund të merren informata të azhurnuara mbi të gjitha tarifat e zbatueshme dhe pagesat për mirëmbajtje;

6.1.5. kohëzgjatja e kontratës, kushtet e ripërtëritjes dhe shkëputjes së shërbimeve dhe kontratës, ekzistenca e çfarëdo të drejte për tërheqje;

6.1.6. të gjitha aranzhimet për kompensim dhe kthim të parave të cilat aplikohen në rast se nivelet e kontraktuara të shërbimit nuk arrihen; dhe

6.1.7. metodat e inicimit të procedurave për zgjidhje të mosmarrëveshjeve;

6.2. njoftimi adekuat për të gjitha synimet për të modifikuar kushtet kontraktuese dhe informimi mbi të drejtën e tyre për tu tërhequr në rast të pranimit të njoftimeve të tilla. Furnizuesit duhet të njoftojnë konsumatorët në mënyrë të drejtpërdrejtë në rast të rritjes së çmimeve, jo më vonë se një (1) periudhë standarde të faturimit para hyrjes në fuqi të rritjes në fjalë;

6.3. pranimi i informatave transparente mbi çmimet dhe tarifat e aplikueshme dhe mbi kushtet dhe afatet standarde, specifikisht në kuptim të qasjes në shërbime të gazit dhe shfrytëzimit të tyre;

6.4. përfitimimi nga procedurat transparente, të thjeshta dhe jo të kushtueshme për trajtimin e ankesave. Këto procedura do të mundësojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë, duke siguruar, për raste përkatëse, një sistem të rimbursimit dhe/ose kompensimit;

6.5. informimin mbi të drejtat e tyre sipas këtij ligji për tu furnizuar me gaz të një cilësie të specifikuar, në bazë të çmimeve të publikuara apo tarifave të rregulluara.

7. Dispozitat e kontratës mbi furnizimin me gaz natyror do të jenë të drejta dhe do të përfshijnë, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, të drejtat dhe obligimet e furnizuesit dhe konsumatorit fundor. Kurdo që kontratat të lidhen me ndërmjetësues, njoftimet e tilla duhet të jepen edhe para lidhjes së kontratës.

8. Kontrata për furnizimin me gaz natyror nuk do të privojë apo pengojë konsumatorin fundor nga e drejta për të shkëputur apo anuluar kontratën e tillë në rast të shfrytëzimit të të drejtës së tij për të ndryshuar furnizuesin, si dhe nuk do t'i imponojë atij obligime financiare shtesë për këtë qëllim, përveç në rastet kur konsumatori jofamiljar dhe furnizuesi janë marrë vesh shprehimisht ndryshe.

Neni 9

Kontrata standarde e furnizimit

1. Rregullatori miraton kontratën standarde të furnizimit, e cila do të përmbajë dispozita për furnizim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm me gaz natyror për konsumatorët familjarë dhe ndërmarrjet e vogla.

2. Furnizuesi që furnizon një konsumator familjar ose ndërmarrje të vogël është i obliguar që të nënshkruajë kontratë standarde të furnizimit.

3. Në bazë të kontratës standarde të furnizimit, furnizuesi mund të refuzojë fillimin e furnizimit me gaz natyror tek një konsumator apo mund të ndërpresë furnizimin me gaz, nëse:

3.1. tubacioni i lidhjes apo pajisjet e konsumatorit rrezikojnë jetën, shëndetin njerëzor, mjedisin apo sigurinë e pronës;

3.2. shfaqet ndonjë rast i forcës madhore, sipas përkufizimit në aktet ligjore në fuqi;

3.3. konsumatori nuk i ka përmbushur obligimet e specifikuar në kontratë të furnizimit, përkundër njoftimeve të furnizuesit mbi këto obligime.

4. Furnizimi i konsumatorëve familjarë apo ndërmarrjeve të vogla mund të refuzohet vetëm në rast të mbizotërimit të rrethanave që shërbejnë si bazë e refuzimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 10

Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë

1. Ministria përgjegjëse për mirëqenie sociale, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energji, Ministrinë e Financave dhe në konsultim me Rregullatorin dhe hisedarët tjerë në sektorin e gazit natyror, do të zhvillojë një program të detajuar për përcaktimin e statusit të konsumatorëve në nevojë, fushëveprimi të të drejtave të tyre, si dhe masave që kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë në mbulimin e kërkesës së tyre për gaz.

2. Programi i trajtimit të konsumatorëve në nevojë socialë i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni do të aprovohet nga Qeveria dhe do të përfshijë nga elementet në vijim:

2.1. caktimin e konsumatorëve në nevojë që përfitojnë nga programi i përcaktuar sipas këtij neni si:

2.1.1. do të jetë i kufizuar në konsumatorët e gazit natyror me të ardhurat më të ulëta që përdorin gaz për furnizim për banimin e përhershëm, ku për përcaktimin e të ardhurave të ulëta, përveç të ardhurave, do të merren parasysh të gjitha asetet në dispozicion;

2.2. do t'i bëhet referencë nivelit maksimal të konsumit të gazit për person duke pasqyruar sezonën, kur përcaktohet niveli i konsumit të gazit për person, do të merret parasysh konsumi total deri në shtatdhjetë (70) metra kub/muaj për një familje me deri katër (4) anëtarë;

2.3. mënyrën e mbështetjes së drejtpërdrejtë nga ana e Qeverisë për konsumatorët në nevojë nga burime të tjera të të ardhurave ndryshe nga tarifat që i ngarkohen të licencuarit, për të shmangur ndërshtetësit dhe shtrembërimin e çmimeve; dhe

2.4. financimi për mbështetje për konsumatorët në nevojë duhet të realizohet në mënyrë jodiskriminuese dhe në veçanti nuk duhet të financohet nga konsumatorët e gazit.

3. Konsumatorët familjarë që përfitojnë nga mbështetja financiare për pagesat për shërbimin e furnizimit me gaz natyror nuk do të lejohen të shfrytëzojnë fondet e tilla për qëllime të tjera.

4. Konsumatorët familjarë që kanë marrë vendim mbi statusin e tyre të konsumatorëve në nevojë sociale kanë të drejtë në mbrojtje të veçantë në përputhje me këtë ligj dhe me programin e zhvilluar sipas paragrafit 1 të këtij neni.

5. Konsumatorët në nevojë sociale kanë të drejtë në shërbim të furnizimit sipas këtij neni për aq kohë sa janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilat do të verifikohen të paktën çdo gjashtë (6) muaj nga autoriteti përgjegjës për mirëqenie sociale. Nëse, për shkak të ndryshimit të rrethanave, konsumatori humb statusin e konsumatorit në nevojë sociale, ai do të fshihet nga regjistri përkatës, por të dhënat e tij do të ruhen për një periudhë prej pesë (5) vitesh pas regjistrimit të tij në regjistrin në fjalë. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes njofton konsumatorin në nevojë sociale dhe furnizuesin e tij, me shkrim dhe brenda tetë (8) ditëve, në lidhje me fshirjen e konsumatorit në nevojë sociale nga regjistri përkatës.

6. Programi i trajtimit të konsumatorëve në nevojë sociale të cekur në paragrafin 1 të këtij neni do të zbatohet në mënyrë që më së paku do ta shtrembërojë konkurrencën në furnizimin me gaz natyror. Ndryshimi ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave nga aktiviteti i furnizuesit për konsumatorët në nevojë sociale të gazit do të mbulohet nga Qeveria.

7. Furnizuesi në kuadër të detyrimeve të shërbimit publik është i detyruar të sigurojë kontratë të furnizimit për të gjithë konsumatorët në nevojë të gazit dhe fillon furnizimin pa vonesë, pasi që konsumatori në nevojë të ketë dorëzuar kërkesë të shoqëruar me dëshmi për përmbushjen e kërkesave nga paragrafi 1 të këtij neni.

8. Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes do të krijojnë dhe mirëmbajnë një regjistër të konsumatorëve në nevojë sociale. Regjistri duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e konsumatorit në nevojë sociale, numrin personal të identifikimit, adresën në të cilën ai furnizohet me gaz, numrin nën të cilin ai është i listuar, llojin e trajtimit të veçantë për të cilin ai ka të drejtë dhe përfitimet që i dhurohen me statusin e konsumatorit në nevojë sociale. Të dhënat nga regjistri mund t'i prezantohen vetëm konsumatorit në nevojë sociale që ka aplikuar për regjistrim në regjistrin përkatës dhe furnizuesit të tij.

9. Të drejtat dhe detyrimet lidhur me konsumatorët në nevojë, të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, do të zbatohen dhe aplikohen në tërësi nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Në veçanti, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do t'i marrë masat e duhura për t'i mbrojtur konsumatorët fundorë në zonat e largëta të cilët janë të lidhur në sistemin e gazit natyror.

10. Furnizuesi që ofron furnizim me gaz për konsumatorët në nevojë krijon mekanizma për ofrimin e asistencës për konsumatorët në nevojë që kanë për qëllim shmangien e shkyçjes së gazit natyror si pasojë e faturave të papaguara.

11. Të gjitha subvencionet për sektorin e energjisë do t'i nënshtrohen dispozitave të legjislativës

në fuqi për ndihmë shtetërore dhe procedurave të monitorimit të parashikuara në të.

12. Bazuar në aktet ligjore në fuqi, masat e duhura si hartimi i planeve kombëtare të energjisë, do të merren në ofrimin e përfitimeve të sigurimeve sociale për të siguruar furnizimin e nevojshëm me gaz për konsumatorët në nevojë, apo sigurimin e mbështetjes për përmirësime të efikasitetit të energjisë, për trajtimin e mungesës së energjisë, aty ku ajo identifikohet, duke përfshirë edhe në kontekst më të gjerë të varfërisë. Masat e tilla nuk do pengojnë hapjen efektive të tregut dhe funksionimin e tij, të rregulluar me këtë ligj, dhe të njoftohen të Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Njoftimet e tilla nuk përfshijnë masat e marra në kuadër të sistemit të përgjithshëm të sigurimeve sociale.

Neni 11

Obligimet e furnizuesit kundrejt konsumatorëve fundorë

1. Çdo furnizues siguron një pikë të kontaktit nga e cila konsumatorët fundorë do të pajisen me të gjitha informatat dhe njoftimet e nevojshme lidhur me të drejtat e tyre, rregulloret aktuale dhe mjetet ekzistuese dhe në dispozicion për zgjidhje të kontesteve. Kjo pikë e vetme e kontaktit gjithashtu do t'i mundësojë konsumatorët fundorë që të:

1.1. marrin njoftime transparente mbi tarifat e aplikueshme dhe mbi afatet dhe kushtet standarde, në lidhje me qasjen dhe shfrytëzimin e shërbimeve;

1.2. t'u ofrohet një zgjedhje e gjerë e metodave të pagesës, të cilat nuk imponojnë diskriminime të padrejta ndërmjet konsumatorëve fundorë. Sistemet e parapagimit do të jenë të drejta dhe do të pasqyrojnë në mënyrë adekuate konsumin e mundshëm. Çdo ndryshim në afatet dhe kushtet duhet t'i pasqyrojë shpenzimet e furnizuesit për sistemet e ndryshme të pagesës;

1.3. marrin informata lidhur me mundësinë për ta ndërruar lirshëm furnizuesin e tyre;

1.4. marrin udhëzime për zbatimin e procedurave transparente, të thjeshta dhe ekonomike që kanë të bëjnë me ankesat e tyre në veçanti, çdo furnizues do të sigurojë që klientët e tij fundorë kanë të drejtë në një standard të mirë të shërbimit dhe se ankesat e tyre trajtohen si duhet dhe ashtu që bëhet e mundur që kontestet të zgjidhen në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë, mundësisht brenda dy (2) muajve, duke siguruar, aty kur kërkohet, sistem të rimbursimit dhe/ose kompensim;

1.5. marrin njoftime të shpeshta dhe të sakta mbi konsumin dhe shpenzimet aktuale të gazit natyror për t'iu mundësuar atyre që të rregullojnë vetë konsumin e tyre të gazit natyror, kjo informatë do të sigurohet duke shfrytëzuar një hapësirë të mjaftueshme kohore, e cila merr parasysh aftësinë e pajisjeve matëse të konsumatorit fundor, duke i kushtuar vëmendje të duhur efikasitetit të këtyre masave dhe pa shpenzime shtesë ndaj konsumatorëve fundorë për këtë shërbim; dhe

1.6. marrë një llogari përfundimtare të mbylljes pas ndërrimit të furnizuesit jo më vonë se gjashtë (6) javë pasi të jetë bërë ndërrimi i furnizuesit.

2. Furnizuesit i ndërmarrin hapat e nevojshëm për t'iu siguruar konsumatorëve të tyre fundorë një kopje të listës kontrolluese të konsumatorëve të energjisë që përmban informata praktike në lidhje me të drejtat e konsumatorëve të energjisë dhe siguron që ato publikohen në kohë të duhur.

3. Çdo furnizues njofton konsumatorët fundorë për ndryshimet në tarifa dhe kushtet e tjera të furnizimit, së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para zbatimit të ndryshimeve të tilla, duke përfshirë informata mbi të drejtën e konsumatorëve fundorë për ndërprerje të kontratës. Njoftimi i tillë nuk është i detyrueshëm nëse ndryshimet kanë të bëjnë me ulje të tarifave ose sigurimin e kushteve më të favorshme të furnizimit. Konsumatorët fundorë janë të lirë që t'i ndërpresin kontratat e tyre nëse nuk i pranojnë kushtet e reja për të cilat janë njoftuar.

4. Çdo furnizues mund të furnizojë konsumatorin fundor vetëm nëse operatori i sistemit përgjegjës tek i cili janë të lidhura stabilimentet e konsumatorit fundor përcakton dhe i konfirmon furnizuesit që konsumatori në fjalë i plotëson kushtet për furnizim të sigurt me gaz natyror.

5. Çdo furnizues do të përgatisë dhe publikojë programin e veprimit për:

5.1. ofrimin e asistencës për konsumatorët fundorë në lidhje me përmbushjen e tyre të detyrimeve kontraktuese për të parandaluar pezullimin e furnizimit;

5.2. mbështetjen e furnizimit të konsumatorëve fundorë në lokacione të largëta;

5.3. mbështetjen e sistemit për stimulimin e prodhimit të gazit natyror nga burimet e ripërtëritshme të energjisë; dhe

5.4. promovimin e efijencës së energjisë.

6. Çdo furnizues njofton rregullisht konsumatorët fundorë të tij mbi masat për përmirësimin e efijencës së energjisë në konsumin fundor të energjisë.

7. Çdo furnizues, në pajtim me kontratat e lidhura, i propozon konsumatorëve fundorë të tij se furnizuesi në fjalë të faturojë dhe mbledhë pagesën për:

7.1. përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe/apo shpërndarjes;

7.2. sigurimin e shërbimeve plotësuese; dhe

7.3. pagesat e tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

8. Çdo furnizues do ta ngarkojë pagesën për gazin e furnizuar natyror dhe shërbimet e lidhura në bazë të një fature që do të jetë e qartë dhe e kuptueshme.

9. Çdo furnizues do të informojë rregullisht konsumatorët e tij fundorë në lidhje me furnizimin me gazin natyror, përfshirë edhe çështjet mjedisore. Informatat që çdo furnizues i ofron për konsumatorët e tij fundorë do të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Rregullatori.

10. Rregullatori do t'i ndërmerr hapat e nevojshëm për të siguruar njoftimet që furnizuesit i ofrojnë për konsumatorët e tyre fundorë, të prezantohen në mënyrë të besueshme, të qartë dhe të krahasueshme. Rregullatori mund të vendosë elemente të këtyre njoftimeve të vihen në dispozicion për pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror, duke siguruar që nuk shpalosen informatat e ndjeshme komerciale mbi pjesëmarrës ose transaksione të caktuara.

11. Çdo furnizues ndërmerr hapat e nevojshëm që kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të

konsumatorëve të tij fundorë, si dhe trajtimin e ankesave të konsumatorëve fundorë në mënyrë efikase, duke përfshirë edhe zgjidhjet jashtëgjyqësore të kontesteve. Rregullatori për Energji mbikëqyrë mënyrën në të cilën trajtohen ankesat, në përputhje me këtë ligj dhe aktet e tjera ligjore në fuqi.

Neni 12

Ndërtimi dhe operimi i rrjetit të transmetimit dhe obligimet tjera

1. Ndërtimi dhe operimi i rrjetit të ri të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit dhe tubacioneve të drejtpërdrejta do të bëhet në përputhje me Ligjin për Partneritetet Publike Private dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
2. Ministria, në pajtim me legjislacionin në fuqi, do ta vlerësojë nevojën për zgjerimin e infrastrukturës ekzistuese të rrjetit të gazit për të mundësuar integrimin e gazit nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Neni 13

Bashkëpunimi rajonal i operatorëve të sistemit të transmetimit

1. Operatorët e sistemit të transmetimit promovojnë aranzhimet operative për të siguruar menaxhimin optimal të rrjetit dhe promovojnë zhvillimin e shkëmbimit të energjisë, ndarjen e bashkërenduar të kapaciteteve ndërkufitare nëpërmjet zgjidhjeve jodiskriminuese që bazohen në treg, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të ankandëve të nënkuptuara për ndarjen afatshkurtër dhe për integrimin e mekanizmave balancues.
2. Ministria dhe Rregullatori do të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse të vendeve të rajonit, me qëllim të integritit të tregut nacional në nivel rajonal, si hap i parë drejt krijimit të një tregu të brendshëm krejtësisht të liberalizuar. Veçanërisht Ministria dhe Rregullatori do promovojnë dhe lehtësojnë bashkëpunimin në nivel rajonal të operatorëve të sistemit të transmetimit, përfshirë çështjet ndërkufitare, me qëllim të krijimit të një tregu të brendshëm konkurrues të gazit natyror, të zhvillojnë një kornizë ligjore, rregullative dhe teknike dhe të lehtësojnë integrimin e sistemeve të gazit natyror.
3. Rregullatori do të bashkëpunojë me Bordin Rregullativ të Komunitetit të Energjisë, autoritetet rregullative rajonale dhe operatorët e sistemeve të transmetimit për të siguruar pajtueshmërinë e kornizave rregullative të rajonit, me qëllim të krijimit të një tregu të brendshëm konkurrues të energjisë.
4. Rregullatori do të bashkëpunojë me autoritetet rregullative rajonale, për t'i siguruar Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë, si dhe njëra-tjetrës, informatat e domosdoshme për plotësimin e obligimeve të tyre që rrjedhin nga legjislacioni i zbatueshëm evropian dhe vendor. Do të bëhen përpjekje për të siguruar se gjatë këmbimit të informatave mes palëve do të mbahet niveli i njëjtë i konfidencialitetit.
5. Rregullatori do të bashkëpunojë në nivel rajonal, në mënyrë që:
 - 5.1. të inkurajohet krijimi i aranzhimeve operative për të mundësuar menaxhim optimal të rrjetit, promovuar këmbimet e përbashkëta të energjisë dhe ndarjen e kapaciteteve ndërkufitare në nivel rajonal, përfshirë interkoneksionet e reja që mundësojnë zhvillimin e konkurrencës efektive dhe përmirësimin e shërbimeve të furnizimit pa diskriminim të kompanive furnizuese nga palët nënshkruese të Komunitetit të Energjisë;

5.2. të koordinojë zhvillimin e të gjitha kodeve të rregullimit për operatorët e sistemit të transmetimit dhe palët tjera të tregut; dhe

5.3. të koordinojë zhvillimin e rregullave, të cilat rregullojnë menaxhimin e kongjestionit.

6. Rregullatori mund të nënshkruajë marrëveshje të bashkëpunimit me autoritete rregullative nga rajoni me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit ndërmjet rregullatorëve.

KAPITULLI II OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

Neni 14

Caktimi i operatorëve të sistemeve të transmetimit dhe depozitimit

Qeveria e Republikës së Kosovës përzgjedh në bazë të konkurrencës dhe emëron personat juridikë si kandidatë për operatorë të sistemit të transmetimit dhe të depozitimit. Kandidatët duhet të aplikojnë për licencë tek Rregullatori brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e përzgjedhjes nga Qeveria.

Neni 15

Sthurja e sistemit të transmetimit dhe operatorit të sistemit të transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të organizohet si person juridik i pavarur që nuk është pjesë e një ndërmarrjeje të integruar vertikalisht.

2. Aktivitetet e Operatorit të Sistemit të Transmetimit në kryerjen e detyrave dhe përmbushjen e obligimeve të përcaktuara me këtë ligj, do të jenë të pavarura nga aktivitetet e prodhimit dhe furnizimit të gazit natyror dhe nga interesat tjerë të ndërlidhur afaristë.

3. Pavarësia e Operatorit të Sistemit të Transmetimit konsiderohet e siguar sipas këtij ligji atëherë kur:

3.1. personi apo personat që ushtrojnë kontrollë të drejtpërdrejt apo të tërthortë mbi ndërmarrjen që kryen funksionet e prodhimit apo të furnizimit nuk ushtrojnë kontrollë apo të drejta mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit, qoftë drejtpërdrejtë apo të tërthortë;

3.2. personi apo personat që ushtrojnë kontrollë të drejtpërdrejt apo të tërthortë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit nuk ushtrojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë çfarëdo kontrolli apo të drejtë mbi ndërmarrjet që kryejnë funksione të prodhimit apo furnizimit;

3.3. i njëjti person apo persona nuk kanë të drejtë të emërojnë anëtarë të bordit mbikëqyrës, bordit administrativ apo trupa që përfaqësojnë ligjërisht ndërmarrjen e një operatori të sistemit të transmetimit apo të sistemit të transmetimit, dhe drejtpërdrejt apo tërthorazi, të ushtrojnë kontroll apo çfarëdo të drejta mbi ndonjë ndërmarrje që kryen funksione të prodhimit apo furnizimit;

3.4. i njëjti person nuk ka të drejtë të jetë anëtar i Bordit të drejtorëve, Bordit administrativ apo organeve që ligjërisht e përfaqësojnë ndërmarrjen që kryejnë funksione të prodhimit apo furnizimit dhe të atyre të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

4. Të drejtat të cilave iu referohet në paragrafin 2 të këtij neni përfshijnë, në veçanti:

4.1. autoritetin për të ushtruar të drejta të votimit;

4.2 të drejtën për të emëruar anëtarë në Bordin mbikëqyrës, Bordin administrativ apo në trupat që ligjërisht përfaqësojnë ndërmarrjen; apo

4.3. mbajtjen e shumicës së aksioneve.

5. Ndërmarrjet që kryejnë funksione të prodhimit apo furnizimit nuk kanë të drejtë që të ushtrojnë çfarëdo lloj të drejte mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit si dhe anasjelltas.

6. Në rastin kur personat të cilëve u referohet në paragrafin 2 të këtij neni janë institucione qeveritare ose publike atëherë nuk do të konsiderohet se është i njëjti person ose të njëjtit persona nëse një institucion i veçantë qeveritar/publik ushtron kontroll ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose sistemit të transmetimit, ndërsa një tjetër institucion qeveritar/publik ushtron kontrollë ndaj ndërmarrjes që kryen funksionin e prodhimit ose furnizimit.

7. Para se një ndërmarrje të caktohet si Operator i Sistemit të Transmetimit do të certifikohet sipas procedurave të përcaktuara sipas këtij neni.

Neni 16

Certifikimi i operatorëve të sistemit të transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të certifikohet nga Rregullatori, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullin e tij për Procedurën e Certifikimit.

2. Ndërmarrjet që posedojnë sisteme të transmetimit dhe janë certifikuar nga Rregullatori dhe të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara, me nenin 15 të këtij ligji, miratohen dhe përcaktohen si Operator të Sistemit të Transmetimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Informatat mbi përcaktimin e operatorëve të sistemit të transmetimit do t'i dërgohen Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Neni 17

Certifikimi në lidhje me vendet e treta

Certifikimi në raport me vendet e treta kryhet nga Rregullatori, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullin për Procedurën e Certifikimit.

Neni 18

Detyrat e operatorit të sistemit të transmetimit dhe depozitimit

1. Secili Operator i Sistemit të Transmetimit dhe Sistemit të depozitimit të gazit natyror për të siguruar treg të hapur do të:

1.1. operojë, mirëmbajë dhe zhvillojë, nën kushtet ekonomike, stabilimente të sigurta, të besueshme dhe efikase të transmetimit dhe depozitimit të gazit natyror, me kujdesin e duhur për mjedisin;

1.2. përmbahet nga diskriminimi mes shfrytëzuesve apo klasave të shfrytëzuesve të sistemit, sidomos në favor të ndërmarrjeve të veta të ndërlidhura;

1.3. sigurojë për secilin operator tjetër të Sistemit të Transmetimit, Depozitimit dhe Operator të Sistemit të Shpërndarjes, informata të mjaftueshme për të siguruar që transmetimi dhe depozitimi i gazit natyror të mund të bëhet në pajtim me operimin e sigurt dhe efikas të sistemit të ndërlidhur;

1.4. sigurojë, për shfrytëzuesit e sistemit, informatat e nevojshme për qasje efikase ndaj sistemit.

2. Rregullat e miratuara nga operatorët e sistemit të transmetimit për balancimin e sistemit të transmetimit të gazit do të jenë objektive, transparente dhe jodiskriminuese, duke përfshirë rregullat për ngarkimin e shfrytëzuesve të rrjeteve të tyre për mosbalancimin e energjisë.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të ndërtojë kapacitete të mjaftueshme tejkufitare për të integruar sistemin e transmetimit të gazit natyror të Kosovës me sisteme të ngjashme të Palëve të Komunitetit të Energjisë, për të akomoduar të gjitha kërkesat ekonomikisht të arsyeshme dhe teknikisht të realizueshme për kapacitet, si dhe duke marrë parasysh sigurinë e furnizimit me gaz.

4. Kushtet dhe afatet jodiskriminuese, duke përfshirë tarifat reflektuese të kostos, për ofrimin e shërbimeve të tilla nga operatorët e sistemit të transmetimit dhe depozitimit, do të hartohen dhe propozohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Depozitimit, përkatësisht rregullat e tilla do t'i paraqiten Rregullatorit për miratim. Rregullat e pranuar nga Rregullatori dhe ato të cilat nuk janë refuzuar brenda nëntëdhjetë (90) ditësh do të konsiderohen të miratuara. Pas miratimit, rregullat do të publikohen.

5. Operatorët e sistemit të transmetimit do të prokurojnë energjinë që përdorin për kryerjen e funksioneve të tyre në bazë të procedurave transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg.

6. Operatori i Sistemit të Transmetimit, përveç detyrave të përcaktuara sipas këtij neni, përfshin edhe detyrat si në vijim:

6.1. miratimi i planeve vjetore për zhvillim të sistemit të transmetimit, për një periudhë minimale prej dhjetë (10) vitesh, sipas nenit 22 të këtij ligji, në pajtim me planet investuese të operatorëve të sistemeve tjera;

6.2. miratimi i programeve të pajtueshmërisë, për të siguruar sjellje jodiskriminuese dhe caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin e zbatimit të programit të pajtueshmërisë dhe hartimin e raporteve vjetore, sipas nenit 21 të këtij ligji;

6.3. sigurimi i balancimit të sistemit mbi parimet e kostos minimale, transparencës dhe jodiskriminimit;

6.4. ndërmarrja e masave përkatëse të sigurisë për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe stabilimenteve tjera të ndërlidhura;

- 6.5. sigurimi i konfidencialitetit të informatave komercialisht të ndjeshme të siguruara gjatë zhvillimit të afarizmit, dhe publikimi i informatave në mënyrë që të njëjtat të mund të ofrojnë avantazhe në treg në mënyrë jodiskriminuese;
- 6.6. grumbullimi dhe publikimi i të dhënave dhe informatave të domosdoshme për të përmbushur kërkesat e përcaktuara lidhur me transparencën dhe monitorimin e tregut të gazit natyror, në pajtim me rregullat teknike në zbatim;
- 6.7. krijimi i procedurave transparente dhe efikase për lidhje pa diskriminim të stabilimenteve të depozitimit, sistemeve të shpërndarjes dhe konsumatorëve industrialë në sistem të transmetimit;
- 6.8. garantimi i sigurisë së furnizimit dhe dorëzimi i të dhënave të nevojshme tek Rregullatori, lidhur me raportin e sigurisë së furnizimit sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
- 6.9. ndërmarrja e masave për ngritjen e efijencës së energjisë dhe sigurimin e mbrojtjes së mjedisit;
- 6.10. bashkëpunimi dhe promovimi i aranzhimeve operative dhe avancimit të këmbimeve të energjisë me operatorë të sistemeve tjera, si dhe me palët relevante me interes, me qëllim të themelimit të tregut rajonal të gazit natyror dhe arritjes së liberalizimit të tij, duke i kushtuar kujdes të duhur meritave specifike të licitacioneve për alokim afatshkurtër dhe integritet të mekanizmave balancues;
- 6.11. dorëzimi tek Rregullatori i informatave dhe dokumenteve që nevojiten për t'ia mundësuar Rregullatori ushtrimin e detyrave të veta;
- 6.12. kryerja e të gjitha detyrave tjera të rëndësishme për operimin e sistemit të transmetimit.

Neni 19

Pavarësia e personelit dhe menaxhmentit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit

1. Vendimet në lidhje me emërimin dhe zgjatjen e kontratave, kushteve të punës duke përfshirë kompensimin, si dhe ndërprerjen e mandatit, të personave që janë përgjegjës për menaxhimin dhe/ose anëtarët e organeve administrative të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, do të merren nga Organi Mbikëqyrës i Operatorit të Sistemit të Transmetimit, i emëruar në pajtim me nenin 20 të këtij ligji.
2. Identiteti, kushtet që përcaktojnë mandatin, kohëzgjatjen dhe ndërprerjen e mandatit të personave të emëruar nga Organi Mbikëqyrës për emërim apo zgjatje të kontratës së personave përgjegjës për menaxhimin ekzekutiv dhe/ose si anëtarë të organeve administrative të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, si dhe arsyet për cilindo vendim të propozuar për ndërprerjen e një mandati të tillë, duhet njoftuar Rregullatori. Ato kushte dhe vendime që përmenden në paragrafin 1. të këtij neni hyjnë në fuqi vetëm nëse Rregullatori nuk ka parashtruar ndonjë kundërshtim brenda njëzetënjë (21) dite nga njoftimi.
3. Rregullatori mund të kundërshtojë vendimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni në rastet kur:

3.1. dalin dyshime në kuptimin e pavarësisë profesionale të personit të emëruar si përgjegjës për menaxhimin dhe/ose si anëtar i organeve administrative; si dhe

3.2. në rastin e ndërprerjes së parakohshme të mandatit, ka dyshime në lidhje me arsyetimin e asaj ndërprerjeje të parakohshme.

4. Personat përgjegjës për menaxhimin dhe/ose anëtarët e organeve administrative, si dhe punëtorët e operatorit të sistemit të transmetimit nuk mund të mbajnë interesa mbi apo të pranojnë përfitime financiare, drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga asnjë pjesë e ndërmarrjes së gazit natyror, përveç nga operatori i sistemit të transmetimit .

5. Të drejtat efektive të apelimit tek Rregullatori duhen garantuar për çdo ankesë nga personat përgjegjës për menaxhimin dhe/ose anëtarët e organeve administrative të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, kundër ndërprerjeje të parakohshme të mandateve të tyre.

Neni 20

Bordi i Drejtorëve

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të ketë një Organ Mbikëqyrës, i cili duhet të ketë pushtetin e marrjes së vendimeve të cilat mund të kenë ndikim të konsiderueshëm mbi vlerën e asetëve të aksionarëve brenda Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sidomos vendimet në lidhje me miratimin e planeve vjetore dhe shumëvjeçare financiare, nivelin e borxheve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe shumën e dividendëve që i shpërndahen aksionarëve. Vendimet që bien në fushëveprimin e Organit Mbikëqyrës nuk përfshijnë aktivitetet e përditshme të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe menaxhimin të rrjetit, si dhe ato në lidhje me aktivitetet e domosdoshme për përgatitjen e planit dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit, i cili hartohet në bazë të nenit 22 të këtij ligji.

2. Kur Operatori i Sistemit të Transmetimit si Ndërmarrje Publike, gjegjësisht kur sistemi i transmetimit është në pronësi publike, emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Bordit të drejtorëve të Ndërmarrjes bëhet sipas paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni.

3. Procesi i aplikimit të kandidatëve, organizimit dhe kriteret tjera të zgjedhjes së anëtarëve të Bordit të drejtorëve zhvillohen sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

4. Përveç detyrave dhe përgjegjësisive të anëtarëve të Bordit të drejtorëve të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Bordi i drejtorëve duhet të aplikojë edhe dispozita të këtij ligji në lidhje me detyrimet ndaj Rregullatorit.

Neni 21

Programi i pajtueshmërisë dhe Zyrtari i pajtueshmërisë

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të krijojë dhe zbatojë Programin e pajtueshmërisë në të cilin vendosen masat me qëllim që të mos lejohen sjellje diskriminuese si dhe të sigurojë që të bëhet monitorimi i tij në mënyrë adekuate. Programi i pajtueshmërisë përcakton obligimet specifike për punonjësit e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për arritjen e objektivit të Programit. Programi i pajtueshmërisë miratohet nga Rregullatori. Pa paragjykuar kompetencat e Rregullatorit, pajtueshmëria me Programin e pajtueshmërisë monitorohet në mënyrë të pavarur nga Zyrtari i pajtueshmërisë.

2. Zyrtari i pajtueshmërisë emërohet nga Organi mbikëqyrës, dhe miratohet nga Rregullatori.

Rregullatori mund ta refuzojë miratimin e Zyrtarit të pajtueshmërisë vetëm për arsye të mungesës së pavarësisë apo kapacitetit profesional. Zyrtari i pajtueshmërisë mund të jetë person fizik ose person juridik.

3. Zyrtari i pajtueshmërisë është përgjegjës për:

3.1. monitorimin e zbatimit të Programit të pajtueshmërisë;

3.2. përgatitjen e raportit vjetor, ku përfshihen masat e ndërmarra me qëllim të zbatimit të Programit të pajtueshmërisë. Raporti vjetor dorëzohet në Rregullatori;

3.3. raportimin tek Organi Mbikëqyrës dhe dhënien e rekomandimeve lidhur me programin e pajtueshmërisë dhe zbatimin e tij;

3.4. njoftimin e Rregullatorit për çfarëdo shkelje substanciale përkitazi me zbatimin e programit të pajtueshmërisë; dhe

3.5. raportimin tek Rregullatori për çfarëdo marrëdhënie ekonomike dhe financiare ndërmjet aksionarit dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

4. Zyrtari i pajtueshmërisë duhet t'ia dorëzojë Rregullatorit vendimet e propozuara për planin e investimeve apo për investimet individuale në rrjet. Kjo duhet të bëhet më së voni deri në kohën kur menaxhmenti apo organi kompetent administrativ i Operatorit të Sistemit të Transmetimit i dorëzon ato tek Organi Mbikëqyrës.

5. Në rastet kur Organi Mbikëqyrës apo vetë aksionari kanë marrë një vendim që ka efekt të parandalimit apo të shtyrjes së një investimi të planifikuar, në planin dhjetë (10) vjeçar, për t'u realizuar brenda tre (3) viteve të ardhshme, Zyrtari i pajtueshmërisë i raporton për këtë Rregullatorit e cila pastaj duhet të veproj në pajtim me nenin 22 të këtij ligji.

6. Rregullatori miraton kushtet e punësimit, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e mandatit të Zyrtarit të pajtueshmërisë. Këto kushte duhet të jenë të tilla që të sigurojnë pavarësi të Zyrtarit të pajtueshmërisë duke i siguruar, veç tjerash, edhe të gjitha burimet e nevojshme për përmbushjen e detyrave të tij. Gjatë mandatit të tij, Zyrtari i pajtueshmërisë nuk ka të drejtë të mbajë asnjë pozitë tjetër profesionale, të ushtrisë përgjegjësi apo interes, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në ndërmarrjet tjera të energjisë apo ndonjë organizatë, ose agjenci qeveritare.

7. Zyrtari i pajtueshmërisë raporton rregullisht, qoftë në mënyrë verbale apo me shkrim, tek Rregullatori dhe ka të drejtë që të raportojë edhe tek Organi Mbikëqyrës i Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

8. Zyrtari i pajtueshmërisë merr pjesë në të gjitha takimet e menaxhmentit apo organeve administrative të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, dhe ato të Organit Mbikëqyrës. Zyrtari i pajtueshmërisë merr pjesë në të gjitha takimet që adresojnë çështjet si në vijim:

8.1. kushtet për qasje në rrjet, në veçanti përkitazi me tarifën, shërbimet e qasjes së palëve të treta, ndarjen e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionit, transparencën, balancimin dhe tregjet dytësore;

8.2. projektet e ndërmarrë me qëllim të funksionimit, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të sistemit të transmetimit, duke përfshirë investimet në linjat e reja të transmetimit, në zgjerim të kapaciteteve dhe në optimizimin e kapaciteteve ekzistuese;

8.3. blerjet apo shitjet e energjisë të domosdoshme për operimin e sistemit të transmetimit.

9. Zyrtari i pajtueshmërisë monitoron pajtueshmërinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit lidhur me konfidencialitetin e informacionit.

10. Zyrtari i pajtueshmërisë ka qasje në të gjitha të dhënat relevante dhe në zyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe në të gjitha informatat e nevojshme për kryerjen e detyrave të tij.

11. Organi mbikëqyrës mund ta shkarkojë Zyrtarin e pajtueshmërisë pas miratimit paraprak nga Rregullatori. Zyrtari i pajtueshmërisë shkarkohet për arsye të mungesës së pavarësisë apo kapacitetit profesional pas kërkesës së Zyrës së Rregullatorit për Energjisë.

12. Zyrtari i pajtueshmërisë ka qasje në zyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit pa njoftim paraprak.

Neni 22

Zhvillimi i rrjetit dhe kompetencat për marrjen e vendimeve për investime

1. Çdo vit, operatorët e sistemit të transmetimit do t'i dorëzojnë Rregullatorit një plan dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit, në bazë të parashikimit të ofertës dhe kërkesës, pasi të kenë konsultuar gjitha palët e përfshira relevante. Ai plan i zhvillimit të rrjetit duhet të përmbajë masa efikase për të garantuar përshtatshmërinë e sistemit dhe sigurinë e furnizimit.

2. Në veçanti, plani dhjetë (10) vjeçar i zhvillimit të rrjetit duhet që:

2.1. t'i njoftojë pjesëmarrësit e tregut me infrastrukturën kryesore të transmetimit që duhet ndërtuar apo avancuar në dhjetë (10) vitet e ardhshme;

2.2. të përmbajë gjitha investimet e vendosura dhe të identifikojë investimet e reja që do të duhet të ekzekutohen në tre (3) vitet e ardhshme; si dhe

2.3. të ofrojë një kornizë kohore për të gjitha projektet investive.

3. Kur elaborohet plani dhjetë (10) vjeçar i zhvillimit të rrjetit, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të ofrojë supozime të arsyeshme për evoluimin e prodhimit, furnizimit, konsumit dhe këmbimeve me vendet tjera, duke marrë parasysh planet investive për rrjetet rajonale dhe ato të Komunitetit të Energjisë.

4. Rregullatori duhet të konsultojë gjithë shfrytëzuesit aktualë ose potencialë mbi planin dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit në mënyrë të hapur dhe transparente. Personat apo ndërmarrjet që pretendojnë të jenë shfrytëzues potencialë të rrjetit mund të obligohen të arsyetojnë ato pretendime. Rregullatori do të publikojë rezultatin e procesit të konsultimeve, e sidomos nevojat e mundshme për investime.

5. Rregullatori do të shqyrtojë nëse plani dhjetë (10) vjeçar i zhvillimit të rrjetit mbulon gjitha nevojat për investime, të identifikuar gjatë procesit të konsultimeve, si dhe nëse është në

përputhje me Strategjinë e Energjisë të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë një perspektivë evropiane për përshtatshmërinë e furnizimit. Nëse ka dyshime në lidhje me përputhshmërinë me Strategjinë e Energjisë të Komunitetit të Energjisë, Rregullatori duhet të konsultojë Bordin e Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë. Rregullatori mund t'i kërkojë operatorit të sistemit të transmetimit që të ndryshojë dhe plotësojë planin e tij dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit.

6. Rregullatori monitoron dhe vlerëson zbatimin e planit dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit.

7. Në rrethanat ku operatori i sistemit të transmetimit, përveç kur ka arsye të jashtëzakonshme jashtë kontrollit të tij, nuk ekzekuton një investim i cili, sipas planit dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit, është dashur ta ekzekutojë në tre (3) vitet vijuese. Rregullatori duhet të ndërmarrë së paku një nga këto masa për të siguruar që investimi i tillë është bërë, apo nëse investimi i tillë është ende relevant, në bazë të planit më të vonshëm të zhvillimit të rrjetit:

7.1. t'i kërkojë operatorit të sistemit të transmetimit që të ekzekutojë investimet e tilla;

7.2. të organizojë një procedurë të hapur tenderimi për investitorët për investimin e tillë; ose

7.3. të obligojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit që të pranojë rritjen e kapitalit për të financuar investimet e nevojshme dhe të lejojë investitorët e pavarur që të marrin pjesë në kapital. Aty ku Rregullatori ka ushtruar kompetencat e veta sipas paragrafit 7.2 të këtij neni, ai mund të obligojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit që të pajtohet me një apo më shumë nga këto pika në vijim:

7.3.1. financimin nga cilado palë e tretë;

7.3.2. ndërtimin nga cilado palë e tretë;

7.3.3. që vet t'i ndërtoi asetet të reja;

7.3.4. që vet të operoi me asetet e reja.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet t'i ofrojë investitorëve gjitha informatat e nevojshme për të realizuar investimin, do të lidhë asetet e reja me rrjetin e transmetimit, si dhe përgjithësisht bën përpjekjet më të mira për të mundësuar zbatimin e projektit investiv. Rregullimet përkatëse financiare i duhen nënshtruar miratimit nga Rregullatori.

9. Në rastin kur Rregullatori ka ushtruar kompetencat e veta sipas paragrafit 7 të këtij neni rregulloret përkatëse të tarifave duhet të mbulojnë shpenzimet e investimeve në fjalë.

Neni 23

Konfidencialiteti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Depozitimit

1. Pa paragjykuar nenin 32 të këtij ligji dhe Ligjin për Rregullatorin e Energjisë ose ndonjë obligim tjetër ligjor për zbulimin e informatave, secili operator i sistemit të transmetimit dhe depozitimit duhet ta ruajë fshehtësinë e informatave të ndjeshme komerciale, të siguruar në vazhden e kryerjes së punëve të tij, si dhe ta ndalojë zbulimin në mënyrë diskriminuese të informatave për veprimtarinë e vet, të cilat mund të jenë me përparësi komerciale.

2. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe depozitimit, në kontekstin e shitjeve apo blerjeve të gazit natyror nga ndërmarrjet gjegjëse, nuk do të abuzojnë me informatat e ndjeshme komerciale, të siguruara nga palët e treta, në kontekstin e ofrimit apo negocimit të qasjes ndaj sistemit.

KAPITULLI III OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES

Neni 24

Caktimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Qeveria e Republikës së Kosovës për zgjedh në bazë të konkurrencës dhe emëron një (1) ose më shumë persona juridikë si kandidatë për Operator të Sistemit të Shpërndarjes. Kandidati duhet të aplikojë për licencë tek Rregullatori brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e përzgjedhjes nga Qeveria.

Neni 25

Detyrat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. Secili Operator i Sistemit të Shpërndarjes do të:

1.1. jetë përgjegjës për të siguruar që sistemi i shpërndarjes të mund të siguroj kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e gazit dhe të operojë, mirëmbajë dhe zhvillojë, nën kushtet ekonomike, një sistem të sigurt, të besueshëm dhe efikas, me kujdesin e duhur për mjedisin dhe eficiencën e energjisë;

1.2. përmbahet nga diskriminimi mes shfrytëzuesve apo klasave të shfrytëzuesve të sistemit, sidomos në favor të ndërmarrjeve të veta të ndërlidhura;

1.3. sigurojë për secilin operator tjetër të sistemit të transmetimit dhe/ose depozitimit informata të mjaftueshme për të siguruar që transmetimi dhe depozitimi i gazit natyror të mund të bëhet në mënyrë të pajtueshme me operimin e sigurt dhe efikas të sistemit të interkonektuar;

1.4. sigurojë për shfrytëzuesit e sistemit informatat e nevojshme për qasje efikase ndaj sistemit.

2. Rregullat e miratuara nga operatorët e sistemit të shpërndarjes për balancimin e sistemit të shpërndarjes së gazit do të jenë objektive, transparente dhe jodiskriminuese, duke përfshirë rregullat për ngarkimin e shfrytëzuesve të rrjeteve të tyre për mosbalancimin e energjisë.

3. Kushtet dhe afatet jodiskriminuese, duke përfshirë tarifat që reflektojnë koston, për ofrimin e shërbimeve të tilla nga operatorët e sistemit të shpërndarjes, hartohen dhe propozohen nga operatori i sistemit, në pajtim me nenin 41 të këtij ligji.

4. Rregullat të cilave iu referohet në paragrafin 2 të këtij neni, i paraqiten Rregullatorit, të cilat pas miratimit publikohen.

Neni 26**Pavarësia e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes**

1. Nëse Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e një ndërmarrjeje të integruar vertikalisht, ai do të jetë i pavarur, së paku në kuptimin e formës së vet ligjore, organizimit dhe vendimmarrjes, nga aktivitetet tjera që nuk janë të lidhura me shpërndarjen. Kjo kërkesë nuk do të përmbajë obligimin për ndarjen e pronësisë mbi pasuritë e sistemit të shpërndarjes nga ndërmarrja e integruar vertikalisht.

2. Për të siguruar pavarësinë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni vlejné këto kritere minimale:

2.1. personat përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk mund të marrin pjesë në strukturat e kompanisë të ndërmarrjes së integruar të gazit natyror, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për operimin e përditshëm të prodhimit, transmetimit dhe furnizimit të gazit natyror;

2.2. merren masa të përshtatshme për tu siguruar që interesat profesionale të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes janë marrë parasysh në atë mënyrë që sigurojnë se ata janë të aftë për të vepruar në mënyrë të pavarur;

2.3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të ketë të drejta efektive të vendimmarrjes, pavarësisht nga ndërmarrja e integruar e gazit natyror, në lidhje me asetet e domosdoshme për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit. Kjo nuk duhet ta pengojë ekzistimin e mekanizmave të nevojshëm koordinues për të siguruar mbrojtjen e të drejtave ekonomike dhe të mbikëqyrjes menaxheriale të kompanisë amë në lidhje me kthimin mbi asetet e rregulluara tërthorazi, në pajtim me nenin 31 të këtij ligji, në kompaninë vartëse. Për qëllime të kryerjes së këtyre detyrave, operatori i sistemit të shpërndarjes do të ketë në dispozicion të gjitha resurset e nevojshme, përfshirë ato njerëzore, teknike, financiare dhe fizike;

2.4. në veçanti, në kontekst të nënparagrafit 2.3 të këtij neni, kjo do t'i mundësojë kompanisë amë që ta miratojë planin vjetor financiar, apo ndonjë instrument tjetër ekuivalent, të operatorit të sistemit të shpërndarjes, si dhe të përcaktojë kufijtë globalë mbi nivelet e detyrimeve të kompanisë së saj vartëse. Kjo nuk i lejon kompanisë amë që të ofrojë udhëzime në lidhje me operacionet e përditshme, e as në lidhje me vendimet individuale në lidhje me ndërtimin apo avancimin e linjave të shpërndarjes, të cilat nuk tejkalojné kushtet e planit të miratuar financiar, apo ndonjë instrumenti ekuivalent;

2.5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes harton programin e pajtueshmërisë, që parashikon masat që sigurojnë përjashtimin e sjelljes diskriminuese dhe siguron mbikëqyrjen adekuate të tij. Programi përcakton obligimet e veçanta të cilat i përmbushin të punësuarit. Një raport vjetor, që përcakton masat e ndërmarrja, do të parashtrohet nga personi apo organi përgjegjës për monitorimin e programit të pajtueshmërisë tek Rregullatori, i cili publikohet. Zyrtari i pajtueshmërisë i Operatorit i Sistemit të Shpërndarjes do të jetë plotësisht i pavarur dhe do të ketë qasje në të gjitha informatat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe të çfarëdo ndërmarrje të ndërlidhur, të nevojshme për ta përmbushur detyrën e vet;

2.6. kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e një ndërmarrjeje të integruar

vertikalisht, atëherë duhet të monitorohet nga Rregullatori dhe Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ashtu që të mos përfitoj nga integrimi vertikal i saj dhe të shtrembëroj konkurrencën. Veçanërisht Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk do të krijoj konfuzion në lidhje me identitetin e veçantë të furnizuesit si pjesë e ndërmarrjes së integruar vertikalisht.

Neni 27

Konfidencialiteti i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. Pa paragjykuar nenin 22 të këtij ligji, apo ndonjë obligim tjetër ligjor për zbulimin e informatave, secili Operator i Sistemit të Shpërndarjes ruan fshehtësinë e informatave të ndjeshme komerciale të siguruara në vazhden e kryerjes së punëve të tij, si dhe ndalon zbulimin në mënyrë diskriminuese të informatave mbi veprimtarinë e vet, të cilat informata mund të jenë me përparësi komerciale.

2. Operatorët e Sistemit të Shpërndarjes, në kontekstin e shitjeve apo blerjeve të gazit natyror nga ndërmarrjet gjegjëse, nuk do të abuzojnë me informatat e ndjeshme komerciale të siguruara nga palët e treta në kontekstin e ofrimit apo negociimit të qasjes ndaj sistemit.

Neni 28

Sistemet e mbyllura të shpërndarjes

1. Rregullatori miraton rregullat për kryerjen e veprimtarisë së shpërndarjes brenda një sistemi të mbyllur, duke pasur në konsideratë se ky sistem vepron si i izoluar brenda një lokaliteti të kufizuar gjeografik në të cilin zhvillohen aktivitete industriale apo ekonomike në kushte të caktuara që:

1.1. për arsye specifike teknike apo të sigurisë, operacionet apo procesi i prodhimit fabrikimit i përdoruesve të atij sistemi janë të integruar ; apo

1.2. ai sistem shpërndan gazin natyror në radhë të parë për nevoja të pronarit të operatorit të sistemit ose vetë operatorin e sistemit apo të ndërmarrjeve të ndërlidhura të tyre.

2. Rregullatori mund ta lirojë Operatorin e Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes nga kërkesa e nenit 34 të këtij ligji që tarifatat, apo metodologjitë që mundësojnë kalkulimin e tyre, të miratohen para se të hyjnë në fuqi në pajtim me nenin 48 të këtij ligji.

3. Nëse zbatohet lirimi nga detyrimet si parashihet në paragrafin 2 të këtij neni, çmimet ekzistuese gjegjësisht kompensimet ose metodologjia mbi të cilën janë bazuar llogaritjet, mund të revokohen dhe të përshtaten me metodologjinë dhe çmimet e miratuara nga Rregullatori pas një kërkesë të shfrytëzuesit të atij rrjeti.

4. Shfrytëzimi i rrjetit në sistemet e mbyllura të shpërndarjes nga ana e një numri të vogël të familjeve, personave që janë punësuar tek pronari i sistemit të mbyllur apo në çfarëdo forme janë lidhur me të, nuk pengon miratimin e lirimeve nga detyrimet e sistemit të mbyllur të shpërndarjes siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 29

Shthurja e operatorëve të sistemit të depozitimit

1. Nëse Operatori i Sistemit të Depozitimit është pjesë e një ndërmarrjeje të integruar vertikalisht, ai do të jetë i pavarur së paku në aspektin e formës juridike, organizimit dhe vendimmarrjes nga aktivitetet tjera që nuk janë të lidhura me transmetimin, shpërndarjen dhe depozitimin.

2. Për të siguruar pavarësinë e Operatorit të Sistemit të Depozitimit të cekur në paragrafin 1 të këtij neni, do të zbatohen këto kriterë minimale:

2.1. personat përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Depozitimit nuk marrin pjesë në strukturat e kompanisë përgjegjëse të ndërmarrjes së integruar të gazit natyror, drejtpërdrejt apo tërthorazi, për funksionimin ditor të prodhimit dhe furnizimit me gaz natyror;

2.2. do të merren masat e duhura për të siguruar që janë marrë parasysh interesat profesionale të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Depozitimit ashtu që të sigurojnë se janë të aftë për të vepruar në mënyrë të pavarur;

2.3. Operatori i Sistemit të Depozitimit do të ketë të drejta efektive të vendimmarrjes, në mënyrë të pavarur nga ndërmarrja e integruar e gazit natyror, për sa i përket aseteve të domosdoshme për operim, mirëmbajtje dhe zhvillim të rrjetit. Kjo nuk duhet ta pengojë ekzistimin e mekanizmave të nevojshëm koordinues për të siguruar se mbrohen të drejtat ekonomike dhe të menaxhimit të mbikëqyrjes të kompanisë amë në lidhje me kthimin mbi asetet e rregulluara në mënyrë të tërthortë, në përputhje me nenin 32 të këtij ligji, në kompaninë vartëse. Në veçanti, kjo do t'i mundësojë kompanisë amë që ta miratojë planin vjetor financiar, ose ndonjë instrument ekuivalent, të operatorit të sistemit të Depozitimit dhe që t'i vendosë kufijtë globalë mbi nivelet e detyrimeve të degës së saj. Kjo nuk i lejon kompanisë amë që të japë udhëzime lidhur me operacionet ditore, apo në lidhje me vendimet individuale që kanë të bëjnë me ndërtimin apo avancimin e objekteve të depozitimit, që nuk tejkalojnë kushtet e planit të miratuar financiar, apo ndonjë instrumenti tjetër ekuivalent; dhe

2.4. Operatori i Sistemit të Depozitimit harton programin e përmbushjes që parashikon masat për të siguruar që përjashtimin e sjelljes diskriminuese dhe siguron monitorimin adekuat të kësaj përmbushjeje. Programi i përmbushjes përcakton obligimet e veçanta të të punësuarve për t'i përmbushur këto objektiva. Një raport vjetor, që përcakton masat e marra, duhet të dorëzohet nga personi ose organi përgjegjës për monitorimin e programit të përmbushjes tek Rregullatori dhe i njëjti duhet të publikohet.

Neni 30

Transparenca e ndërmarrjeve të energjisë

1. Rregullatori duhet të sigurojë që ndërmarrjet e energjisë të licencuara për aktivitete të gjenerimit, shpërndarjes dhe furnizimit do t'i ndajnë llogaritë e tyre të brendshme për të gjitha këto aktivitete, sikur po të ishin kryer aktivitetet në fjalë nga ndërmarrje të ndryshme, me qëllim të evitimit të diskriminimit, ndërsuvencionimit dhe pengimit të konkurrencës.

2. Të gjitha ndërmarrjet e energjisë do të kenë llogari të ndara për aktivitetet e licencuara të energjisë dhe për aktivitetet tjera, dhe do të sigurojnë auditimin e tyre.

3. Furnizuesi publik do të mbajë llogari të ndara për furnizim të konsumatorëve të privilegjuar dhe konsumatorëve tjerë, sikur po të ishin kryer këto aktivitete nga ndërmarrje të ndryshme, dhe do të sigurojë auditimin e llogarive të tilla.

Neni 31

Operatori i Sistemit të Kombinuar

Kërkesat për pavarësinë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, të cilat janë përcaktuar në nenin 26 të këtij ligji nuk do ta parandalojnë operimin e një Sistemi të Kombinuar të Transmetimit, Depozitimit dhe Shpërndarjes, me kusht që operatori të jetë në pajtueshmëri me kërkesat lidhur me shthurjen dhe pavarësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

Neni 32

E drejta e qasjes ndaj llogarive

1. Rregullatori, në përputhje me nenin 33 të këtij ligji, ka të drejtë qasjeje në llogaritë e ndërmarrjeve të gazit natyror.

2. Rregullatori ruan fshehtësinë e informatave të ndjeshme komerciale, duke marrë parasysh, që zbulimi i informatave të tilla mund të bëhet nga Rregullatori kur kjo është e domosdoshme për t'i kryer funksionet e veta.

Neni 33

Shthurja e llogarive

1. Zyra e Rregullatorit për Energji siguron që llogaritë e ndërmarrjeve të gazit natyror të mbahen në pajtim me paragrafët 2 deri në 5 të këtij neni. Aty ku ndërmarrjet përfitojnë nga përjashtimet e këtyre dispozitave, në bazë të nenit 51 të këtij ligji, ato së paku do të mbajnë llogaritë e tyre të brendshme në pajtim me këtë nen.

2. Ndërmarrjet e gazit natyror, pa marrë parasysh sistemin e tyre të pronësisë apo formën ligjore, do të hartojnë, të paraqesin për revizion dhe publikojnë llogaritë e tyre vjetore, në pajtim me legjislacionin në fuqi me llogaritë vjetore të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar. Ndërmarrjet që ligjërisht nuk janë të obliguara t'i publikojnë llogaritë e tyre vjetore do ta mbajnë një kopje të këtyre në dispozicion të publikut në zyrën e tyre qendrore.

3. Ndërmarrjet e gazit natyror, në llogari mbajtjen e tyre të brendshme, do të mbajnë llogari të veçanta për secilën veprimtari në transmetim, shpërndarje, dhe depozitim, siç do të ishin të obliguara të bënin nëse veprimtaritë e tilla do të bëheshin nga ndërmarrjet e ndara, me qëllim të shmangies së diskriminimit, subvencionimit të tërthortë dhe çrregullimit të konkurrencës. Ndërmarrjet mbajnë llogari, të cilat mund të jenë të konsoliduara, për aktivitete tjera gazi që nuk ndërlihet me transmetimit, shpërndarjen, dhe depozitimin.

4. Të ardhurat nga pronësia e rrjetit transmetimit/shpërndarës do të specifikohen në llogari. Ato do të mbajnë llogari të veçanta për aktivitetet mbi konsumatorët e privilegjuar dhe aktivitetet për konsumatorët tjerë. Aty ku është e mundur, ato do të mbajnë llogari të konsoliduara për aktivitete tjera, përveç gazit. Llogaritë e brendshme do të përfshijnë bilancin e gjendjes dhe llogaritë e fitimit dhe të humbjes për secilën veprimtari.

5. Revizioni, i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni në veçanti do të verifikojë respektimin e obligimit të shmangies së diskriminimit dhe subvencioneve të tërthorta, të përcaktuara në

paragrafin 3 të këtij neni.

6. Ndërmarrjet, në llogaritë e tyre të brendshme, do t'i specifikojnë rregullat për ndarjen e pasurive dhe detyrimeve, shpenzimeve dhe të hyrave, si dhe për zhvlerësimin, e pa paragjykuar rregullat e llogari mbajtjes në fuqi, të cilat i respektojnë në hartimin e llogarive të veçanta, të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni. Këto rregulla të brendshme mund të ndryshohen vetëm në raste të jashtëzakonshme. Ndryshimet e tilla duhet përmendur dhe arsyetuar mirë.

7. Llogaritë vjetore paraqesin brenda shënimeve të veta secilin transaksion të një madhësie të caktuar të bërë me ndërmarrjet gjegjëse.

Neni 34

Qasja e palës së tretë

1. Operatorët e sistemeve të transmetimit, depozitimit dhe shpërndarjes do të lejojnë ndërmarrjet e gazit natyror, duke i përfshirë ndërmarrjet furnizuese, të kenë qasje pa diskriminim në rrjetin e transmetimit, depozitimit dhe të shpërndarjes dhe në depozitim në linjë të tubacioneve, në pajtim me rregullat dhe me tarifat e miratuara dhe të publikuara nga Rregullatori. Tarifat duhet të jenë transparente dhe jodiskriminuese.

2. Dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni nuk do t'i ndalojnë përmbylljen e kontratave afatgjate nëse ato janë në përputhje të synimit të këtij ligji, në kontest të promovimit të konkurrencës. Operatorët e sistemit të transmetimit, nëse është e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të tyre, duke përfshirë edhe ato në lidhje me transmetimin ndërkufitar, do të kenë qasje në rrjetin e operatorëve tjerë të sistemit të transmetimit.

3. Qasja për palët e treta, ngjashëm me ato të specifikuara në paragrafin 1. të këtij neni, do të lejohet edhe për rrjetet e tubacioneve të rrjedhës së sipërme, duke përfshirë stabilimentet që ofrojnë shërbime teknike për qasje të tillë, përveç për pjesët e rrjeteve ose të stabilimenteve të tilla, që përdoren për operacionet e prodhimit vendor në lokacionin e terrenit ku prodhohet gazi. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes duhet të ofrojnë shërbime jodiskriminuese për të gjithë shfrytëzuesit e rrjetit.

4. Qasja e specifikuar në paragrafin 3 të këtij neni do të ofrohet me qëllim të arritjes së një tregu konkurrent të gazit natyror, duke marrë parasysh sigurinë dhe rregullsinë e furnizimeve, kapacitetet të cilat ofrohen apo mund të vihen në dispozicion, si dhe mbrojtjen e mjedisit. Në kuptim të këtij paragrafi duhet merren parasysh:

4.1. nevoja për të refuzuar qasjen kur ka mospërputhje të specifikimeve teknike, të cilat nuk mund që me arsye të tejkalohen;

4.2. nevoja për t'i shmangur vështirësitë që nuk mund me arsye të tejkalohen dhe do të mund të komprometimin prodhimin efikas, të rrjedhshëm dhe të planifikuar të ardhshëm të hidrokarbureve, duke përfshirë edhe ato nga fushat e qëndrueshmërisë së skajshme ekonomike;

4.3. nevoja për t'i respektuar nevojat e arsyeshme me bazë të pronarit, apo operatorit të rrjetit të tubacioneve në rrjedhën e sipërme për transportin dhe përpunimin e gazit dhe interesat e gjithë shfrytëzuesve të rrjetit të tubacioneve të rrjedhës së sipërme, apo stabilimenteve gjegjëse të përpunimit apo trajtimit që mund të ndikohen; si dhe

4.4. domosdoshmëria e zbatimit të ligjeve dhe procedurave administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi, për dhënien e autorizimit për prodhimin apo zhvillimin në rrjedhë të sipërme.

5. Rregullatori do të nxjerrë rregulla për zgjidhjen e kontesteve në lidhje me qasjen ose me refuzimin për të lejuar qasje për secilin stabiliment të përcaktuar me këtë ligj. Rregullatori publikon informacione për rrjedhën, metodologjinë dhe për strukturën e tarifave.

6. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet ta bëjë publik informacionin e detajuar në lidhje me shërbimet që ofrojnë dhe me kushtet e duhura për të aplikuar, së bashku me informacionet e nevojshme teknike, për përdoruesit e rrjetit për të pasur qasje efektive në rrjet. Me qëllim që të sigurohen tarifat transparente, objektive dhe jodiskriminuese dhe të lehtësohet përdorimi efektiv i rrjetit të gazit.

7. Kundër vendimit përfundimtar të Rregullatorit, pala ka të drejtë të hapë konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente në përputhje me Ligjin për Konfliktet Administrative.

Neni 35

Refuzimi i qasjes

1. Operatorët e sistemit të transmetimit, shpërndarjes dhe depozitimit, mund ta refuzojnë qasjen ndaj sistemit në bazë të mungesës së kapaciteteve, apo në rastet kur qasja në sistem mund t'i pengojë ata në kryerjen e obligimeve të shërbimit publik, në bazë të vështirësive serioze ekonomike dhe financiare me kontratat "merr-ose-paguaj", duke marrë parasysh kriteret dhe procedurat e përcaktuara me nenin 32 të këtij ligji. Refuzimi i tillë duhet të arsyetohet me prova.

2. Ministria mund të kërkojë nga një ndërmarrje e gazit natyror që refuzon të ofrojë qasje për stabilimentet e saj në bazë të mungesës së kapaciteteve ose të mungesës së lidhjes për investime të nevojshme deri në masën që do të ishte ekonomikisht e arsyeshme ose kur një konsumator i mundshëm është i gatshëm të paguajë për zgjerim të kapacitetit.

Neni 36

Infrastruktura e re

1. Interkonekcionet e mëdha të reja ndërmjet Kosovës dhe vendeve tjera, si dhe stabilimenteve të depozitimit, me kërkesë, mund të mos i nënshtrohen zbatimit të dispozitave të nenit 34 dhe nenit 48 të këtij ligji, nën këto kushte:

1.1. investimi duhet ta nxisë konkurrencën në furnizimin me gaz, si dhe të përmirësojë sigurinë e furnizimit;

1.2. niveli i rrezikut në lidhje me investimin është i tillë që investimi nuk do të bëhej nëse përjashtimi lejohet;

1.3. infrastruktura duhet të jetë pronë e një personi fizik apo juridik që është i ndarë së paku në kuptimin e formës së tij ligjore nga operatorët e sistemit **ku** do të ndërtohet ajo infrastrukturë;

1.4. shpenzimet të ngarkohen mbi shfrytëzuesit e asaj infrastrukture;

- 1.5. përjashtimi të mos çrregullojë konkurrencën apo funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të gazit, e as funksionimin efikas të sistemit të rregulluar, me të cilën lidhet infrastruktura.
2. Dispozitat nga paragrafi 1 i këtij neni do të vlejë edhe për rritjet e konsiderueshme të kapacitetit në infrastrukturën ekzistuese, si dhe për modifikimet e infrastrukturave të tilla, të mundësojnë zhvillimin e burimeve të reja të furnizimit me gaz.
3. Rregullatori, në bazë të rasteve, mund të vendosë të lejojë përjashtimin e përcaktuar me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, vetëm në pajtim me kriteret e përcaktuara në këtë nen.
4. Kur infrastruktura gjendet në territor të më shumë se një palë të Komunitetit të Energjisë, që kalon kufirin mes Kosovës dhe një pale tjetër të Komunitetit të Energjisë, Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë mund të nxjerrë opinion këshillëdhënës për Zyrën e Rregullatorit për Energji dhe autoritetin rregullativ të një pale tjetër të Komunitetit të Energjisë, i cili mund të shfrytëzohet si bazë për vendimin e tij për përjashtim, brenda dy (2) muajsh pas datës së pranimit të kërkesës për përjashtim nga autoritetet rregullative në fjalë.
5. Kur autoritetet rregullative në fjalë pajtohen me kërkesën për përjashtim brenda gjashtë (6) muajsh nga data në të cilën e njëjta është pranuar nga autoriteti i fundit rregullativ, ato do ta njoftojnë Bordin Rregullativ të Komunitetit të Energjisë për vendimin e tyre.
6. Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë do t'i ushtrojë detyrat të cilat i janë bartur autoriteteve rregullative përkatëse të palëve të Komunitetit të Energjisë, në bazë të këtij neni:
 - 6.1 kur të gjitha autoritetet rregullative nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë pajtim gjatë një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga data në të cilën kërkesa për përjashtim është pranuar nga së paku njëra prej autoriteteve rregullative;
 - 6.2. pas pranimit të një kërkesë të përbashkët nga autoritetet rregullative;
7. Të gjitha autoritetet rregullative bashkërisht mund të kërkojnë që periudha të cilës i referohet në nënparagrafin 1 të paragrafit 6 të këtij neni të zgjatet edhe për deri në tre (3) muaj shtesë.
8. Para nxjerrjes së vendimit, Rregullatori do të konsultohet me autoritetet rregullative relevante dhe me parashtruesit e kërkesave.
9. Përjashtimi mund të vlejë për tërë apo gjegjësisht për pjesë të caktuara, të infrastrukturës së re, infrastrukturën ekzistuese me rritjen e konsiderueshme të kapacitetit, apo për modifikimin e infrastrukturës ekzistuese.
10. Në vendimin për ta lejuar përjashtimin, në bazë të rasteve, duhet marrë parasysh nevoja për imponimin e kushteve në lidhje me kohëzgjatjen e përjashtimit dhe qasjen jodiskriminuese ndaj infrastrukturës. Kur vendoset mbi kushtet e këtij nënparagrafi, duhet marrë parasysh, në veçanti, kohëzgjatjet e kontratave, kapacitetet shtesë që do të ndërtohen apo modifikimin e kapaciteteve ekzistuese, kohëzgjatja e projektit dhe rrethanat vendore;
11. Kur lejohet përjashtimi, Rregullatori mund të vendosë mbi rregullat dhe mekanizmat për menaxhimin dhe ndarjen e kapacitetit. Rregullat do të kërkojnë që të gjithë përdoruesit potencialë të infrastrukturës të ftohen për të paraqitur interesin e tyre në kontraktimin e kapacitetit para alokimit të kapaciteteve në infrastrukturën e re, përfshirë nevojat për përdorim vetjak të tyre.

Rregullatori do të kërkojë që në rregullat e menaxhimit të kongestionit të përfshihen edhe rregulla që përcaktojnë obligimin për të ofruar kapacitetet e pashfrytëzuara në treg, dhe do të përcaktojë që përdoruesit e infrastrukturës të kenë të drejtë të tregojnë kapacitetet e tyre të kontraktuara në treg sekondar. Në vlerësimin e vet të kriterëve të cilave iu referohet në nënparagrafët 1.1, 1.2 dhe 1.4 të këtij neni, Rregullatori do të merr parasysh rezultatet e procedurës së alokimit të kapaciteteve në fjalë.

12. Vendimi për lejimin e përjashtimit, duke përfshirë edhe kushtet e përcaktuara të këtij paragrafi, do të arsyetohet me prova dhe do të publikohet. Pa zbuluar informata të ndjeshme komerciale, vendimi do të përmbajë:

12.1. arsyetimin e detajuar e bazës mbi të cilën Rregullatori ka lejuar apo refuzuar përjashtimin, së bashku me një referencë ndaj paragrafit 1 të këtij neni, përfshirë dispozitat relevante mbi të cilat vendimi në fjalë është bazuar, përfshirë informatat financiare që justifikojnë nevojën për përjashtim;

12.2. analizën e kryer mbi efektin e lejimit të përjashtimit në konkurrencë dhe funksionim efektiv të tregut të brendshëm të gazit;

12.3. arsyet mbi periudhën e lejimit të përjashtimit dhe përpjesën e kapacitetit të gjithmbarshëm të infrastrukturës së gazit në fjalë që do të përjashtohet;

12.4. në rast se përjashtimi ndërlidhet me një interkonektor, rezultatet e konsultimit me shtetet apo autoritetet rregullative përkatëse; dhe

12.5. kontributin e infrastrukturës në diversifikimin e furnizimit me gaz.

13. Pa marrë parasysh dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni, Rregullatori mund të kërkojë nga Bordi Rregullativ që të dorëzojë, opinionin e vet lidhur me kërkesën për përjashtim. Ky opinion do të publikohet bashkërisht me vendimin.

14. Rregullatori do t'ia dërgojë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë pa vonesë kopjen e çdo kërkesë për përjashtim që ajo pranon. Vendimi do t'i njoftohet pa vonesë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë nga Rregullatori, së bashku me të gjitha informatat relevante që kanë të bëjnë me vendimin përkatës. Këto informata mund t'i dërgohen Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në formë të përmbledhur, në mënyrë që Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë t'i mundësohet marrja e një vendimi të bazuar.

15. Brenda dy (2) muajsh nga dita e pranimit të njoftimit, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mund të nxjerr opinion me të cilin fton Zyrën e Rregullatorit për Energji që të ndërrojë apo tërheqë vendimin për të lejuar përjashtimin. Kjo periudhë prej dy (2) muajsh mund të zgjatet edhe për dy (2) muaj tjerë në rast të kërimit të informatave shtesë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Kjo periudhë shtesë do të fillojë të rrjedhë nga dita pas pranimit të informatave të kompletuara. Periudha fillestare dy (2) mujore mund të zgjatet edhe në rast se për këtë pajtohen Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe Rregullatori.

16. Në rast se informatat e kërkuara nuk ofrohen brenda periudhës së përcaktuar në kërkesë, njoftimi do të konsiderohet se është tërhequr, përveç nëse para skadimit të periudhës në fjalë ose është zgatur periudha në pajtim mes Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe Rregullatorit, përmes një deklarate të arsyetuar, e ka njoftuar Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë se ajo e konsideron njoftimin si të plotë.

17. Rregullatori do të merr parasysh për aq sa është e mundur opinionin e Sekretariatit të Komunitetit për Energji që rekomandon ndryshimin apo tërheqjen e vendimit për përjashtim. Në rastet kur vendimi përfundimtar dallon nga opinioni i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, Rregullatori do të sigurojë dhe publikojë, së bashku me vendimin e vet, edhe arsyet për marrjen e tij.

18. Opinioni i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë mbi vendimin për përjashtim nuk do të jetë i vlefshëm pas dy (2) vitesh nga nxjerrja e tij, në rast se infrastruktura nuk është startuar deri atëherë, dhe pesë (5) vite nga nxjerrja e tij, në rast se infrastruktura ende nuk është lëshuar në punë përveç nëse Sekretariati i Komunitetit të Energjisë vendosë se vonesat janë rezultat i pengesave madhore që nuk janë nën kontroll të personit të cilit i është lejuar përjashtimi.

Neni 37

Qasja e palëve të treta në sistemin e transmetimit

1. Përveç dispozitave për qasjen e palëve të treta sipas nenit 34 të këtij ligji. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të ofrojë qasje në sistemin e transmetimit në pajtim me kushtet dhe konditat e përcaktuara në Rregullat e Rrjetit të Transmetimit. Në këtë kuptim, Operatori i Sistemit të Transmetimit:

1.1. do të sigurojë ofrimin e shërbimeve në baza jodiskriminuese për të gjithë përdoruesit;

1.2. do të ofrojë shërbime të qasjes së ngurtë dhe të ndërprerë të palëve të treta. Çmimi i kapaciteteve të ndryshueshme do të pasqyrojë probabilitetin e ndërprerjes;

1.3. do t'u ofrojë përdoruesve të sistemit edhe shërbime afatshkurtra edhe shërbime afatgjata.

2. Në lidhje me nënparagrafin 1.1 të këtij neni, në rastet kur Operatori i Sistemit të Transmetimit u ofron të njëjtat shërbime konsumatorëve të ndryshëm, ai këtë do ta bëjë në kushte të barabarta kontraktuese, duke shfrytëzuar kontrata të harmonizuara të transportit dhe/ose në pajtim me Rregullat e Rrjetit të Transmetimit të miratuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

3. Kurdo që kjo është e nevojshme, shërbimet e qasjes së palës së tretë mund të lejohen në bazë të garancive përkatëse për përdoruesit e sistemit, duke pasur parasysh qëndrueshmërinë kreditore të përdoruesve. Garancitë e tilla nuk do të përbëjnë barriera të panevojshme për hyrje në treg dhe do të jenë jodiskriminuese, transparente dhe proporcionale.

4. Kontratat e transportit që janë nënshkruar me data jostandarde të fillimit apo me kohëzgjatje më të shkurtër se kohëzgjatja standarde nuk do të rezultojnë me tarifa më të larta apo më të ulëta që nuk pasqyrojnë vlerën e shërbimit në treg, në pajtim me parimet e përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë

Neni 38

Rregullat e Rrjetit të Transmetimit

1. Rregullat e Rrjetit të Transmetimit do të propozohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit pas konsultimit me pjesëmarrës të sektorit të gazit natyror, dhe do të miratohen nga Rregullatori, në pajtim me nenin 18 të këtij Ligji.

2. Rregullat e Rrjetit të Transmetimit duhet të përmbajnë, së paku, dispozitat në vijim:

- 2.1. afatet, kushtet, detajet teknike dhe specifikacionet minimale operative për qasje të përdoruesve në sistem të transmetimit, përfshirë mes tjerash kufizimin e shërbimeve të qasjes së palëve të treta të cilat ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit;
- 2.2. obligimet për të publikuar të dhënat e domosdoshme për qasje në sistem;
- 2.3. përkufizimin e të gjitha pikave dhe informatave relevante që do duhej të publikohen në momente të caktuara, përfshirë orarin dhe kohën e publikimeve në fjalë;
- 2.4. planifikimin e zhvillimit të sistemit të transmetimit dhe monitorimit të zbatimit të tij;
- 2.5. kushtet teknike për lidhje në sistem të transmetimit;
- 2.6. kushtet për operim të qëndrueshëm dhe të sigurt të sistemit të transmetimit;
- 2.7. rregullat për matje, përfshirë definimin e pajisjeve të matjes;
- 2.8. rregullat për këmbim të të dhënave mbi sasi të planifikuara dhe livruara, në rastet kur matjet ditore nuk janë të mundshme;
- 2.9. pikat virtuale në sistem;
- 2.10. spektri i cilësisë, përbërjes kimike dhe karakteristikave tjera të gazit natyror të pranuar në sistem dhe të livruar nga sistemi;
- 2.11. mekanizmat e alokimit të kapaciteteve dhe procedurat e menaxhimit të kongestionit, në pajtim me nenin 39. të këtij ligji;
- 2.12. këmbimin e të dhënave me operatorë tjerë të sistemit;
- 2.13. lloji i të dhënave dhe mënyra e dorëzimit të tyre nga akterët e tregut për operatorin e sistemit;
- 2.14. rregullat e procedurës në rast të pengesave në sistem dhe në rast të komprometimit të sigurisë së furnizimit me gazin natyror;
- 2.15. procedurat për zgjidhje të kontesteve që dalin nga marrëveshjet e transportit;
- 2.16. Çështjet tjera relevante për operim të sistemit të transmetimit.

Neni 39

Parimet e mekanizmave të alokimit të kapaciteteve dhe procedurave të menaxhimit të kongestionit për operatorët e sistemit të transmetimit

1. Kapaciteti maksimal në të gjitha pikat, përfshirë pikat hyrëse dhe dalëse, do t'i vëhet në dispozicion pjesëmarrësve të tregut, duke marrë parasysh integritetin e sistemit dhe operimin

efikas të rrjetit.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të zbatojë dhe publikojë mekanizmat jodiskriminues dhe transparent të alokimit të kapaciteteve, të cilët do të:

2.1. ofrojnë sinjale të përshtatshme ekonomike për shfrytëzim efikas dhe maksimal të kapaciteteve teknike, lehtësim të investimeve në infrastrukturë të re dhe mundësim të këmbimeve tejkufitare të gazit natyror;

2.2. jenë në përputhje me mekanizmat e tregut, përfshirë tregjet aktuale dhe pikat e tregtimit, përderisa të jenë fleksibil dhe të aftë për t'iu adaptuar rrethanave të një tregu në evoluim; dhe

2.3. jenë në pajtim me parimet e qasjes në rrjete të sistemeve të palëve tjera të Komunitetit të Energjisë.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të zbatojë dhe publikojë procedura jodiskriminuese dhe transparente të menaxhimit të kongestionit, të cilat lehtësojnë këmbimet tejkufitare të gazit natyror në baza jodiskriminuese dhe të cilat do të bazohen në parimet si në vijim:

3.1. në rast të kongestionit kontraktues, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të ofrojë kapacitetet e pashfrytëzuara në tregun primar, së paku një ditë para dhe në baza të papenguara; dhe

3.2. përdoruesit e sistemit që duan të rishesin apo nënkontraktojnë kapacitetin e tyre të kontraktuar në tregun sekondar do të kenë të drejtë të bëjnë një gjë të tillë, pas njoftimit të operatorit të sistemit të transmetimit nga përdoruesit e sistemit të tillë, nën kushtet dhe afatet e përcaktuara në rregullat e Rrjetit të Transmetimit.

4. Në rast të ekzistimit të kongestionit fizik nga Operatori i Sistemit të Transmetimit do të aplikohen mekanizma jodiskriminues dhe transparent të alokimit të kapaciteteve, apo sipas nevojës, nga Rregullatori.

5. Operatori i Sistemit të Transmetimit rregullisht do ta vlerësojë kërkesën për investime të reja në treg. Gjatë planifikimit të investimeve të reja, operatori i sistemit të transmetimit do të vlerësojë kërkesën dhe të merr parasysh sigurinë e furnizimit.

Neni 40

Rregullat e balancimit

1. Rregullat e balancimit do të dizajnohen në mënyrë të barabartë, jodiskriminuese dhe transparente dhe do të bazohen në kritere objektive. Rregullat e balancimit do të pasqyrojnë nevojat e sakta të sistemit, duke marrë parasysh burimet në dispozicion të Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Rregullat e balancimit duhet të jenë të bazuara në treg.

2. Ngarkesat për mosbalancim duhet të pasqyrojnë shpenzimet për aq sa është e mundshme, duke ofruar masa stimuluese të balancimit mes hyrjes dhe daljes së gazit, si dhe duke evituar ndërsuvencionimin mes shfrytëzuesve të sistemit apo barrierat e hyrjes për përdorues të rinj të sistemit.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të publikojë informata të mjaftueshme dhe të besueshme në kohë të duhur mbi statusin e balancimit të shfrytëzuesve të sistemit, të cilat janë të nevojshme për t'ua mundësuar shfrytëzuesve të sistemit ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese në kohë të duhur. Niveli i informatave të ofruara duhet të pasqyrojë nivelin e informatave në dispozicion të operatorit të sistemit të transmetimit. Sigurimi i informatave të përcaktuara në këtë paragraf duhet të bëhet pa pagesë.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të publikojë tarifat për ofrimin e shërbimeve balancuese.

5. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të bashkëpunojë me operatorët e sistemit të transmetimit të palëve tjera të Komunitetit të Energjisë në përpjekje për t'i harmonizuar regjimet balancuese dhe për t'i kanalizuar strukturat dhe nivelet e ngarkesave për mosbalancim, me qëllim të lehtësimit të tregimit të gazit.

6. Rregullat e balancimit duhet të jenë pjesë e Rregullave të Rrjetit të Transmetimit, sipas nenit 38 të këtij ligji.

Neni 41

Rregullat e Rrjetit të Shpërndarjes

1. Rregullat e Rrjetit të Shpërndarjes të cilave iu referohet në paragrafin 3 të nenit 25 të këtij ligji, do të propozohen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, pas konsultimit me pjesëmarrës tjerë të sektorit, dhe do të miratohen nga Rregullatori.

2. Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes do të rregullojë së paku si në vijim:

2.1. zhvillimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të shpërndarjes;

2.2. kushtet teknike për lidhje në sistem të shpërndarjes;

2.3. qasjen në sistem të shpërndarjes;

2.4. rregullat e matjes, përfshirë definimin e pajisjeve matëse;

2.5. procedurat në rast të pengesave në operimin e sistemit të shpërndarjes;

2.6. llojin dhe fushëveprimin e të dhënave të këmbjës me ndërmarrje tjera energjetike dhe përdorues tjerë të sistemit, procedurat dhe dinamikat e këmbimit;

2.7. obligimet e përdoruesve të sistemit të shpërndarjes;

2.8. çështjet tjera të domosdoshme për operim të sistemit të shpërndarjes.

KAPITULLI IV TREGU I GAZIT NATYROR

Neni 42

Fushëveprimi i tregut të gazit natyror

1. Tregu i gazit natyror do të përbëhet nga tregjet e gazit natyror me pakicë dhe shumicë.
2. Transaksionet mes konsumatorëve fundorë dhe furnizuesve të tyre do të realizohen në tregun me pakicë të gazit natyror.
3. Tregu me shumicë i gazit natyror do të përfshijë:
 - 3.1. tregun bilateral të gazit natyror;
 - 3.2. tregun një ditë para të gazit natyror; dhe
 - 3.3. tregun balancues të gazit natyror.
4. Blerja dhe shitja në tregun me shumicë të gazit natyror do të kontraktohet me marrëveshje bilaterale, si dhe në tregjet e organizuara të gazit natyror, tregun një ditë para të gazit natyror dhe tregun balancues të gazit natyror.
5. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të sigurojë shërbimet balancuese nga ofruesit e shërbimeve balancuese në tregun balancues, në pajtim me Rregullat e Balancimit të përcaktuara në Rregullat e Rrjetit të Transmetimit, të miratuara nga Rregullatori. Rregullat e Balancimit do të përkufizojnë afatet dhe kushtet që ndërlidhen me balancimin, përfshirë rregullat për ofruesit e shërbimeve balancuese, prokurimin e shërbimeve balancuese, përcaktimin e sasive që duhet barazuar me ofrues të shërbimeve të balancimit dhe barazimin financiar me ofrues të shërbimeve të balancimit.
6. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të bashkëpunojë me operatorë tjerë të sistemit të transmetimit në mundësimin e krijimit të një tregu balancues në nivel rajonal, me qëllim të garantimit të sigurisë operative dhe funksionimit efektiv të tregut balancues, në bazë të konkurrimit efektiv, jodiskriminimit dhe transparencës.

Neni 43

Organizimi i tregut të gazit natyror

1. Rregullatori miraton Rregullat e Tregut të Gazit Natyror, para furnizimit të parë të gazit në Kosovë.
2. Operatori i tregut të gazit natyror do të jetë përgjegjës për organizimin e tregut të gazit natyror, në bazë të licencës së Rregullatorit, si dhe për lidhjen e tij me tregjet tjera të organizuara të gazit natyror, në pajtim me Rregullat e Tregut.
3. Operatori i Tregut të gazit natyror do të jetë kompani në pronë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Operatori i Sistemit të Transmetimit do të sigurojë pavarësinë funksionale të tij nga Operatori i Tregut të gazit natyror, përfshirë këtu edhe zbatimin e masave përkatëse që

parandalojnë sjelljet diskriminuuese në programin e vet të pajtueshmërisë.

4. Operatori i Tregut të gazit natyror do të realizojë aktivitetet e veta në bazë të licencës së lëshuar nga Rregullatori. Operatori i Tregut të gazit natyror do të kryejë detyrat e veta duke respektuar parimet e transparencës, objektivitetit dhe mosdiskriminimit, nën mbikëqyrjen e Rregullatorit.

5. Operatori i tregut të gazit natyror do të aplikojë një pagesë për organizimin e tregut të gazit natyror, e cila përcaktohet nga Rregullatori, në pajtim me planin operativ vjetor dhe planin financiar të operatorit të tregut të gazit natyror.

6. Operatori i Tregut të gazit natyror do të mbajë llogari të ndara për transaksionet që përfshijnë blerjen dhe shitjen e gazit natyror.

Neni 44

Masat për promovimin e hapjes së tregut

1. Rregullatori, në bashkëpunim me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, do të kryejë hetime mbi funksionimin e tregut të gazit natyror çdo dy (2) vite, duke filluar nga viti i parë pas lëshimit të licencës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit.

2. Nëse është e domosdoshme, Rregullatori, brenda fushëveprimit, kompetencave dhe autorizimeve të veta rregullative, do t'i përcaktojë të gjitha masat e kërkuara dhe proporcionale për promovimin e konkurrencës efikase në treg, duke siguruar kështu funksionimin e rregullt të tregut të gazit natyror. Rregullatori, me iniciativë të vet apo pas parashtrimit të kërkesës nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, do të ndërmerë masa të tilla sa herë që kjo konsiderohet e domosdoshme.

3. Masat të cilave iu referohet në paragrafin 2 të këtij neni do të jenë proporcionale, jodiskriminuuese dhe transparente. Ato masa mund të vëhen në funksion vetëm pas njoftimit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, dhe në bazë të opinionit përkatës të tij.

4. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë do të veprojë mbi njoftimin të cilit i referohet në paragrafin 3 të këtij neni brenda dy (2) muajsh pas pranimit të tij. Kjo periudhë fillon të rrjedhë ditën pas pranimit të informatave të plota. Në rast se Sekretariati i Komunitetit të Energjisë nuk vepron brenda periudhës dy (2) mujore në fjalë, ai do të konsiderohet se nuk ka pasur vërejtje lidhur me masat e njoftuara.

Neni 45

Monitorimi dhe mbikëqyrja e tregut të gazit natyror

1. Rregullatori do të kryejë monitorimin dhe mbikëqyrjen e tregut të gazit natyror, nën kushtet dhe konditat e përcaktuara në këtë ligj dhe në Rregullat e Tregut.

2. Rregullatori, në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, do të sigurojë krijimin e kushteve për konkurrencë efektive në tregun e gazit natyror dhe zhvillimin e tij.

3. Deri më 31 mars të çdo viti, Rregullatori do të përgatisë dhe publikojë raportin mbi tregun e gazit natyror, i cili do të përfshijë së paku një shqyrtim të detajuar të organizimit dhe funksionimit

të tregut të gazit natyror në Kosovë, një analizë të aktiviteteve të pjesëmarrësve të tregut të gazit natyror dhe trendet e të gjitha zhvillimeve në tregun e gazit natyror.

4. Operatori i tregut të gazit natyror dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit, brenda kompetencave të tyre përkatëse, do të analizojnë organizimin e tregut të gazit natyror dhe do t'i propozojnë Zyrës së Rregullatorit për Energji masa për përmirësimin e tij, dhe do ta informojnë Zyrën e Rregullatorit për Energji mbi të gjitha shkeljet indikative apo potenciale të kërkesave të parapara për veprimtari në tregun e gazit natyror.

Neni 46

Tregjet me pakicë

1. Për të lehtësuar zhvillimin e tregjeve funksionale dhe transparente në Komunitet, Kosova duhet të sigurojë që rolet dhe përgjegjësitë e operatorëve të sistemit të transmetimit, operatorëve të sistemit të shpërndarjes, ndërmarrjeve të furnizimit dhe konsumatorëve, si dhe sipas nevojës edhe palëve të tjera në treg të përkufizohen në lidhje me aranzhimet kontraktuese, përkushtimin ndaj konsumatorëve, këmbimin e të dhënave dhe rregullat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, pronësinë e të dhënave dhe përgjegjësitë e njehsimit.

2. Ato rregulla duhen bërë publike, duhen hartuar me qëllim të lehtësimit të qasjes së konsumatorëve dhe furnizuesve në rrjet dhe i duhen nënshtruar shqyrtimit nga Rregullatori apo autoriteteve tjera relevante shtetërore.

Neni 47

Linjat direkte

1. Rregullatori i mundëson secilit konsumator që të furnizohet nëpërmjet një linje direkte nga ndërmarrjet e gazit natyror, kurdo që kjo të jetë e mundur teknikisht dhe ekonomikisht.

2. Rregullatori do t'i përcaktojë rregullat që përcaktojnë kriteret për dhënien e autorizimit për ndërtimin apo operimin e linjave direkte. Në vendosjen e rregullave të tilla, Rregullatori do t'i marrë parasysh çështjet e sigurisë, efikasitetit, integritetit të sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes. Këto rregulla do të jenë objektive, transparente dhe jodiskriminuese në zbatim.

Neni 48

Detyrat dhe obligimet e Rregullatorit

1. Rregullatori do të jetë autoriteti kompetent për monitorimin dhe rregullimin e industrisë së gazit natyror në Kosovë, si dhe do të jetë përgjegjëse për sigurimin e një tregu jodiskriminues, efektivisht konkurrent dhe funksional e efikas të gazit natyror në Kosovë sipas dispozitave të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

2. Rregullatori mund të vendosë obligime për shërbime publike në licencat që jepen për sektorin e gazit natyror.

Neni 49

Mbajtja e shënimeve

1. Ndërmarrjet furnizuese duhet të mbajnë në dispozicion të institucioneve shtetërore, duke përfshirë Zyrën e Rregullatorit për Energji, Autoritetin Kosovar të Konkurrencës dhe

Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, për përmbushjen e detyrave të tyre, për të paktën pesë (5) vjet, të dhënat relevante lidhur me të gjitha transaksionet në kontratat e furnizimit me gaz dhe derivativat e gazit të lidhura me konsumatorët me shumicë dhe operatorë të sistemit të transmetimit.

2. Të dhënat duhet të përfshijnë hollësitë mbi karakteristikat e transaksioneve përkatëse, si kohëzgjatja, livrimi dhe rregullat e vendosjes, sasinë, datat dhe kohën e ekzekutimit, si dhe çmimet e transaksionit dhe mënyrat e identifikimit të konsumatorët me shumicë, bashkë me detajet e specifikuar të gjitha kontratave të pa shërbyera të furnizimit me gaz.

3. Rregullatori mund të vendosë të vërë në dispozicion për gjithë aktorët e tregut elementet e këtyre informatave, me kusht që informatat me ndjeshmëri komerciale mbi aktorët individualë të tregut të mos zbulohen.

Neni 50

Shmangiet në lidhje me zotimet “merr ose paguaj”

1. Nëse një ndërmarrje e gazit natyror përballet, apo konsideron që do të përballet me vështirësi serioze ekonomike dhe financiare për shkak të zotimeve të saj në marrëveshjet “merr ose paguaj” në një apo më shumë kontrata të blerjes së gazit, ajo mund të aplikojë për një shmangie të përkohshme nga detyrimet për t'i ofruar qasje Zyrës së Rregullatorit për Energji.

2. Kërkesat do të paraqiten rast për rast, ose para ose pas refuzimit të qasjes në sistem, sipas vlerësimit të ndërmarrjes së gazit natyror. Në rast të refuzimit të qasjes nga një ndërmarrje e gazit natyror, kërkesat do të paraqiten pa vonesë. Kërkesat do të përcillen me të gjitha informatat e nevojshme mbi natyrën dhe masën e problemit, si dhe mbi përpjekjet e bëra nga ndërmarrja e gazit natyror për ta zgjidhur problemin.

3. Sa i përket situatës të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, nëse nuk ka në dispozicion zgjidhje të arsyeshme, Rregullatori mund të vendosë që të lejojë shmangien. Rregullatori do ta njoftojë pa vonesë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë mbi Vendimin e vet për të lejuar shmangien, së bashku me të gjitha informatat relevante që ndërlidhen me shmangien e tillë. Këto informata mund të dorëzohen në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në formë të përmbledhur, duke i mundësuar Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë marrjen e një Vendimi të bazuar. Brenda tetë (8) javësh pas pranimit të njoftimit, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë do të nxjerrë një opinion me të cilin mund ta ftojë Zyrën e Rregullatorit për Energji që të ndryshojë apo tërheqë Vendimin për të lejuar shmangien e tillë.

4. Në Vendimin e saj mbi lejimin apo jo të shmangies së përkohshme, Rregullatori do të marr parasysh në veçanti kriteret si në vijim:

4.1. synimin për arritjen e një tregu jodiskriminues, transparent dhe konkurrues të gazit;

4.2. nevojën për t'i përmbushur obligimet e shërbimit publik dhe për ta siguruar furnizimin;

4.3. pozitën e ndërmarrjes së gazit natyror në tregun e gazit dhe gjendjen aktuale të konkurrencës në këtë treg;

4.4. seriozitetin e vështirësive ekonomike dhe financiare të përballura nga ndërmarrjet e gazit natyror dhe ndërmarrjet e transmetimit apo konsumatorët;

4.5. datat e nënshkrimit dhe kushtet e kontratës apo kontratave të tilla, duke përfshirë masën deri në të cilën ato mundësojnë ndryshimet në treg;

4.6. përpjekjet që janë bërë për ta gjetur zgjidhjen e problemit;

4.7. masën në të cilën kompania, në rastin e pranimit të zotimeve “merr ose paguaj” do të mund të parashikohej që vështirësitë serioze do të mund të përballeshin nga kompania, duke marrë parasysh dispozitat e këtij ligji;

4.8. nivelin e lidhjes së sistemit me sisteme tjera dhe masën e ndërveprimit mes këtyre sistemeve; dhe

4.9. efektet që lejimi i shmangies do të kishte në zbatimin korrekt të Direktivës përkatëse dhe ligjit sa i përket funksionimit të mirë të tregut të brendshëm të gazit natyror.

5. Ndërmarrjet e gazit natyror të cilave nuk iu është aprovuar dërgimi sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk refuzojnë, apo tani e tutje nuk refuzojnë, qasjen në sistem për shkak të zotimeve “merr apo blej” të pranuar në kontratën e blerjes së gazit. Në këtë kuptim, Rregullatori siguron që dispozitat përkatëse të këtij ligji që rregullojnë qasjen e palëve të treta dhe kontratat e furnizimit me gaz aplikohen në tërësi dhe zbatohen në mënyrë adekuate.

6. Çdo përjashtim, i aprovuar nga Rregullatori publikohet dhe vërtetohet në mënyrë të rregullt.

Neni 51 Dispozitat Kalimtare

Nenet 12, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 24, 26, 29, 33, 34, 37, 47 e këtij ligji do të zbatohen para hyrjes së parë fizike të gazit natyror në sistemin e Kosovës.

Neni 52 Aktet nënligjore

Ministria për zbatimin e këtij ligji nxjerrë akte nënligjore, brenda afatit prej nëntë (9) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 53 Dispozita shfuqizuese

1. Ky Ligj shfuqizon:

1.1. Ligjin Nr.03/-133 për Gazin Natyror.

1.2. Udhëzimin Administrativ Nr.01/2010 për sigurinë e furnizimit në sektorin e gazit natyror.

Neni 54
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-082
16 qershor 2016

Shpallur me dekretin Nr. DL-024-2016, datë 01.07.2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.